


# GUJEMI MET E PARA

TREGIME

SIRI SULEJMANI



8P1. P83 - 32


5

S. P6 SIRI SULEJMANI

# GJEMIMET E PARA

(T r e g i m e )

2360 ~~15292~~



## LAPIDARI NË QAFËN E MALIT

Mars. Atë ditë koha ishte e kthjellët. Nga gryka e Matit frynte një erë e fortë. Ngrita jakën e paradesysë dhe u mbështeta pas një kalibeje të vogël, aty në dalje të urës. Rreth një gjysmë ore u kota me përfytyrimin e qytetit të panjohur verior, drejt të cilit isha nisur. Një «Skodë» shytë u fut tej në urë; dola në anë të xhadesë dhe ngrita dorën.

— Hajdeni — më tha shoferi dhe më tregoi vendin pranë tij.

Në kabinë ishin edhe dy pasagjerë. U nisëm. Maqina ishte e re, kabina e ngrohtë, e pastër. Në dy xhamet anësore ishin varur një palë perde blu të pikturuara nga një dorë e zakonshme. Shoferi ishte nga ata që ja dinë vlerën profesionit dhe ruajnë dinjitetin e tyre.

— Kam dëgjuar përrëshirën e pishës, por të them të drejtën nuk e kam të qartë prodhimin e saj.

— E po, kështu është, dhe unë nuk mund ta kuptoj mirë detyrën e veterinerit — bisedonin të dy pasagjerët.

Vëmendjen ma tërhoqi një tufë me lule të freskëta e mbuluar me një letër të kuqe transparente,

nga ato që mbështjellin zakonisht disa sende ushqimore. «Epo do të jenë të veterinerit, kushedi si do ta ketë hallin...» — mendova me vete dhe i hodha sytë jashtë kabinës.

Xhadeja e asfaltuar dukej sikur ndiqte deri në fund rrjedhën e lumbit. Gjatë luginës ishte shpérndarë një mjegull e hollë; përreth binin në sy shenjat e para të përtëritjes së natyrës.

E kaluam qytetin R... Sa më tepër ngjiteshim drejt veriut, aq më pak ndjehej pranvera. Lart, mallet pushonin nën peshën e dëborës. Shkëlqimi i saj sikur u jepte jetë dhe drurëve të zhveshur.

Në F... zbritën të dy pasagjerët, buqeta me lule mbeti aty në atë shportën prej xunkthi, që si dukej shoferi e mbante shpesh me vete.

«Mos i harruan ata, apo mos është e këtij?... Po ç't'i dojë ky lulet? Kë mund të presë a të përcjellë?... E pse çuditesh? Djalë i ri është, ndoshta ja ka lënë zemrën dikujt, në buzë të rrugës, në ndonjë shkollë fshati...» sqarova veten.

— Jeni i martuar? — e pyeta jo pa qëllim.

— Po, kam edhe dy fëmijë.

Përgjegjja e tij ma preu rrugën, por nuk ma shohti kureshtjen rreth buqetës me lule. Sa vinte rruga bëhej më e keqe. Shoferi përqëndroi vëmendjen përpara dhe mundohej t'u shmangej gropave të thella. Po ecnim në heshtje. Ju afroam një mali të lartë e të mbuluar deri në gjoks me borë. Maqina nisi të uturonte e të ngjitte si me përtim kthesat e forta që rreshtoheshin gjatë shpatit të pjerrët.

Rruga ngjitej përpjetë me aq kthesa, sa nuk mund të merrje me mend se nga vazhdonte më tej e ku do të dilte më në fund.

— Në majë të malit do të dalim kështu, more usta?

— Pak më poshtë se maja, ja tek ajo qafa — m'u përgjegj ai me buzë në gaz.

— Të zot jeni ju shoferat, — e ngacmova më tej për pak muhabet.

— Epo.., ç'të bëjmë, ky është profesioni ynë. Çdo njeri në profesionin e tij i zoti duhet të jetë.

— E kam fjalën se ju kini shumë vështirësi dhe rreziqe.

— Kështu është me mjetet e komunikacionit. Pse mos e ka më të lehtë piloti apo marinari?

— Sidoqoftë ata e kanë një shpresë te parashuta ose te tapa, kurse juve, po ju dolën gomat e maqinës nga kjo rrugë!... — i thashë duke shikuar nga gremina e frikshme që shtrihej poshtë nesh.

— Hëm... keni të drejtë — më tha dhe uti trupin për të hapur kapakun e ajrimit. Pastaj vazhdoi: — Ne shoferët rrallë mendojmë të keqen, ndryshe timoni do të mbetej pa zot.

Dolëm në qafë. Fër një çast maqina dukej sikur do të fluturonte në erë, pastaj ra në rrugë të drejtë dhe para nesh u hap një horizont i gjerë.

Shoferi e ndaloi maqinën, e fiku dhe, pasi siguroi frenin e dorës, më tha:

— Më falni një minutë. — Mori buqetën me lule dhe doli nga kabina.

— Po kjo? — mendova i quditur. — Kë mund të presë ky në këtë shkretëtirë të egër? Zgjata kokën nga xhami, po ai më humbi pas maqinës. Mos ka këtu ndonjë kafe malore? Ishte e para herë që kaloja asaj rruge. Kureshtja nuk më la, doli nga kabina dhe shikova përreth. Asnjë shenjë jete.

Ju afrova me kujdes buzës së rrugës. Përpara këmbëve të mia shtrihej gremina, kurse në krah të majtë ngrihej një shkëmb i madh. Atje në rrëzë të shkëmbit kishte qëndruar shoferi me kokën ulur. Përpara tij ngrihej një pllakë në formën e një lapidari të vogël. Pranë asaj pllake, në sfondin e bardhë të borës, shkëlqente buqeta me lule. U mundova të largohesha pa ja prishur qetësinë shoferit, po ai më ndjeu.

— Më falni, ndoshta u vonova?

— Jo, ju lutem, mund të rrini sa të dëshironi.

— Jo, jo, do të nisemi, le të rrinë ato — më tha duke shikuar edhe një herë lulet.

U nisëm të heshtur. Motori nuk gjëmonte më, po lëshonte një zhurmë të mbytur, sikur t'i kishin zënë frymën. Rruga vazhdonte përsëri me kthesa të forta, por tanë, në zbritje. Mendja më kishte mbetur në qafën e malit, kureshtja nuk po më linte të qetë. Më kot prita se mos shoferi më hapte vetë bisedën, vendosa ta pyes. Më pas nxora paketën dhe ja zgjata. Pasi ndezëm cigaren, e pyeta:

— Më falni se... mund tju lëndojoj ndonjë plagë, por jam kureshtar të di se ç'ka ndodhur atje në qafë, për kë i latë ato lule.

— Kini të drejtë... Unë do t'jua tregoja vetë, por thashë të zbresim një herë këtë të tatëpjetë. Këtu poshtë është një kafe dhe do të pushojmë pak, si thoni?

— Me gjithë qejf — ju përgjegja i lehtësuar.

Në anën e sipërme të xhades, pranë një shkëmbi të thepisur, rrëzë të cilit buronte me zhurmë ujët, ishte një ndërtësë dykatëshe: sipër hotel dhe poshtë kafe-restorant.

— Kjo është kafja juaj, siç duket — i thashë në kohën që zumë vend në një tryezë pranë dritares.

— Më mirë thuaj banesa jonë — m'u përgjegj ai me buzë në gaz. — Këtu nuk ka natë që të mos flejë një shofer, sidomos në netët e ftohta të dimrit, kur qafa e malit zihet nga bora.

Ai përmendi qafën dhe unë i dhashë të kuptonte se pikërisht atje prisja të dilte.

— Fare rastësisht ndodhi që të kaloja për herë të parë kësaj rruge — filloi ai tregimin, — ngaqë maqinat e parkut tonë shumë rrallë vinin deri këtu. Kjo ndodhi dy vjet më parë. Pasi kërkova djathë në R..., agjencia më urdhëroi të nisësha për në Tropojë. Në fillim kundërshtova, sepse nuk kisha urdhër nga drejtoria ime, dhe as fletëudhëtimi për këtë rrugë. Veç kësaj, të them të drejtën dhe qejfi nuk ma kishte.

«Kemi urdhër të prerë nga ministria, që çdo maqinë në gjendje të mirë teknike, e cilitdo park qoftë, të ngarkohet me ushqime dhe të niset për në Tropojë. Fshatrat janë në rrezikun e blokimit nga dëbora», — më tha agjenti dhe më tregoi telegramin e ministrisë poshtë xhamit të tryezës. Pra ishte fjala për një detyrë serioze. Kuptohet që më mbeti vetëm të pyesja se ku do të ngarkoja.

— «Në magazinën e rezervave ushqimore — më tha agjenti. Atje ka aq punëtorë, sa për një çerek ore do të jesh gati për udhë. O burra, mos e humb kohën; para gjysmë ore është nisur dhe Xhemal Alia, mund ta zësh rrugës».

Këtë emër e kisha lexuar në shtyp dhe e kisha dëgjuar në biseda të ndryshme; ai ishte një nga shoferët e dëgjuar në republikë, po nuk kisha

patur rast të njihesha me të, Ngarkova shpejt dhe u nisa. Nga Rrësheni e këtej rruga ishte fare e panjohur për mua, kështu si për ju sot. Ishte koha e keqe, binte një shi i fortë, që dukej sikur nuk do të pushonte kurrë. Rruga ishte më e keqe se sot dhe nuk mund të ecja me shpejtësi që të mund ta arrija maqinën tjetër përpara... Deri në F... shkova me shi; andej ja kishte marrë shtruar një borë e imët. Kishte akoma edhe tri-katër orë ditë, por nga maja e malit po zbriste një mjegull e dendur, që nuk të lejonte fare të shikoje rrugën. Ndeza dritat dhe u mundova të ecja pak më shpejt. Kur dola në qafë, mjegulla mbeti pas. Aty frynte një erë e fortë, që ulërinte kur përplasej në cep të kabinës. E zura maqinën e parë; ajo nuk po çante dot borën. Shoferi po jepte e merrte duke dhënë prapa e përpara me qëllim që të ngjeshte borën, që atje në qafë era e kishte grumbulluar më tepër. Nxora njëherë kokën nga xhami, ishte shumë ftohët, era të priste fytyrën. Maqina e parë u afroa prapsht deri afér maqinës sime. Atëherë munda ta shoh fytyrën e shoferit të panjohur. Ai më përshtëndeti me kokë dhe ma bëri me dorë që të mos ngutesha. Pastaj humbi në kabinë dhe lëshoi maqinën përpara me gjithë fuqinë. Pas pesëmbëdhjetë-njëzet metrash, maqina xhiroi në vend, ai ja dha si duket gjithë gazin. Gomat e prapme xhironin me shpejtësi duke i vërtitur tej copat e ngjeshura të dëborës. Ndërkohë ato zunë në tokë të fortë dhe maqina u hodh përpara me kolpo. Pak më tej rrëshqiti anash dhe u mënjanua te buza e greminës.

U hodha menjëherë nga maqina dhe dola i trembur:

— Mbaje, mbaje, se dole nga rruga! Por ishte e kotë. Gomat e para dolën nga buza dhe maqina u var tërthor drejt asaj gremine që e patë me sytë tuaj... Atëhere i bërtita me sa fuqi pata: «Hidhu... hidhu nga maqina!» Ai kishte mundësi ta bënte këtë, pasi rrëshqitjen nga buza e xhadesë, maqina nuk e pati të menjëhershme... Nuk u hodh dhe nuk di nëse më dëgjoi. Me sa kuptova ai po mundohej ta përplaste maqinën diku pas ndonjë shkëmbi, aty afër, pa marrë shpejtësi drejt greminës që vazhdon te thikë më tepër se pesëqind metra. Por më kot. Maqina u kthye me turi drejt përroit dhe mori vrull. Ishte vështirë të prisje shpëtimin...

Këtu shoferi ndali një çast, rrudhi vetullat, shtrëngoi buzët me njëra-tjetrën dhe, pasi fiku bishtin e cigares duke e shtypur në taketuke, i hodhi sytë jashtë dritares së vogël me dy palë xama. Ndejti ashtu një çast, me nofulla të shtrënguara, si të shikonte sërisht atë skenë, që me sa duket i kishëte mbetur në mend si një kujtim i hidhur që nuk harrohet lehtë.

— Nuk ka më keq se sa të bësh sehir fatkeqësinë e tjetrit — vazhdoi ai tregimin, — të shikosh vdekjen që i kërcënöhët shokut dhe të mos kesh asnë mundësi për ta ndalur. Pas ndonja njëqind mettrash a më tepër, maqina u përplas pas një pishë të madhe. Pisha u shkul dhe mbeti pas një shkëmbi, që ngrihej pranë saj. Në trup më shkuau mornica, por e mblodha veten dhe u nisa tatëpjetë nëpër dëborë. Maqina ishte përplasur pas trungut të trashë të pishës në krahun e shoferit, pikërisht

në drejtim të timonit. Porta dhe një pjesë e kabinës ishin shqyer, përzhitur dhe rënë në tokë me gjithë shoferin. Largova llamarinat dhe i hodha duart shoferit. Me zor e tërroqa dhe e shtriva mbi gjunjët e mi. Fytyrën ja kishte mbuluar gjaku, por ishte gjallë. Nxora shaminë dhe i fshiva gjakun. Atëhere kuptova se ishte vrarë rëndë. Një e çarë e thellë i përshkonte faqen e majtë deri në tëmth. Gjaku nuk po ndalej. Mbështeta shaminë mbi plagë dhe i fola: — Xhemal... o Xhemal!

Ai hapi sytë përgjysmë dhe, pasi më shikoi një çast si të ishte zgjuar nga një gjumë i thellë, më pyeti me zë të mekur:

— Pse?.. Pse erdhe këtu ti?

— Më thuaj, vëlla, ku të dhemb më shumë, je vrarë në trup?

— Ikë... ikë atje... të presin qindra njerëz që kërkojnë ndihmën tënde... Ikë... Unë... është e kotë... nuk do jetoj më...

— Jo, jo, ti nuk ke gjë; ja, do të kthehem i menjëherë te mjeku.

— Jo vëlla... Ikë përpara... po ai... ku është?...

— Cili ai — e pyeta po i plagosuri nuk mundi të më fliste më.

Me mundim e hodha në kraha trupin e tij dhe u nisa përpjetë. Nisi të fliste përcart fjalë e emra të ngatërruara. Dora, me të cilën e kisha shtrënguar për mesi m'u qull në gjak. Kjo m'i preu shpresat. Megjithatë vazhdova të ngjitesha më mundim. Nuk kisha arritur në gjysmën e rrugës, papritur shtanga në vend, gjunjët m'u prenë, më lanë forcat, përp-

ra meje, në rrëzën e një gëmushe të mbuluar me borë, ishte shtrirë përbys një njeri me kapotë ushtarake. E ula ngadalë shoferin se mos e lëndoja, por tashmë kujdesi ishte i kotë. Ai kishte pushuar së ndjeri dhëmbjen. Kishte vdekur mbi shpinën tim. Ju afrova njeriut të mbetur përbys. E ktheva praptas. Ishte djalë i ri, ushtar. Me sa dukej ai ishte hedhur nga maqina para se të përplasej, me shpresë se do të shpëtonte.

Ishte gërvishur lehtë në fytyrë, kurse nga goja i rridhte gjak. I mora kokën në duar dhe i fola: «Ushtar, o ushtar...» Zërin tim e mori era që ulurinte si e tërbuar, ushtari nuk m'u përgjegj. E lëviza, e përsëri i fola:

— Oh, — rënkoj dhe pasi u kapërdi me zor, shtrëngoinofullat. E rrëmbeva në duar dhe u nisë përpjetë djerrinës. Pasi e shtrova në krevatin tim në kabinë, i lëviza duart dhe i fola prapë. U përmend, hapi sytë. Dy sy të mekur, të lodhur e të tronditit, më shikonin me habi si sy fëmije të mitur.

— Si je... a je më mirë — e pyeta.

— Si është ai... Ku?

Nuk di c'deshte të shtonte më tej, fjalën nuk e mbaroi, i mbylli përsëri sytë dhe lëshoi një psherëtimë të thellë. Mendova të kthehesha menjëherë prapa, në spitalin më të afërt, por mendja më shkoi te shoferi. Si mund ta lija atë vetëm, më malet, me natën që po binte, më egërsirat.

«Jo, jo... kjo është e rëndë» mendovat me vete, u hodha nga kabina e u lëshova poshtë nëpër borën e dendur. Trupi i shoferit ishte rënduar, ndoshta kështu m'u duk mua që isha kapitur. E mblodha

veten duke marrë forca nga jeta e atij, që më prishte lart në kabinë dhe mora përpjetë greminës. E rregullova dhe shoferin në karroceri Ktheva maqinën, e kontrollova dhe njëherë ushtarin. Ai u përmend prapë dhe diçka deshte të më thoshte, se për çfarë deshte të më pyeste, po prapë nuk e kuptoja ç'kërkonte. Ruga e keqe i shkaktonte dhimbje ushtarit. Rënkimet e tij më sillnin përpara xhamit të maqinës fatkeqësinë e qafës së malit. Nuk do ta harroj atë udhëtim sa të jem. Ecja përpara, po mendjen e kisha prapë te ushtari.

— Kadalë — më foli diku; po si mund të humbisja sekondat, kur jeta e tij matej me minuta? Nuk besoja që të arrija deri në F., po arrita; arrita atje pas gati dy orësh.

Spitali i vogël në F. nuk kishte vende, prandaj ushtarin e shtruan në krevatin e mjekut të rojes, kurse shoferin e vdekur e vendosën në një dhomë, karshi ushtarit. Nuk munda të qëndroja më. Më merreshin mendtë. U futa në dhomën e rojes dhe u tulata pranë sobës. Trupi më ziente si të më ishin futur miliona miza në gjak. Ngrohtësia e zjarrit më mbiu fare dhe padashur m'u mbyllën sytë. Nuk di sa kaloi e sa fjeta, mbaj mend që u zgjova i trembur nga një gjëmim i rëndë. U ngrita e dola nga dhoma. Në oborrin e spitalit lëviznin infermierë e mjekë.

— Është helikopteri që vjen nga Tirana me mjekë të tjerë për ushtarin, — spjegoi roja i spitalit. Helikopteri u ul në një shesh pak më tej spitalit. Pas pak zbritën dy mjekë dhe u futën në dhoniën e ushtarit për të vazhduar mjekimet. Jashtë po

gdhihej, ndërsa ne prisnim në ankth vendimin e mjekëve.

— Po vjen babai i shoferit — tha dikush te dera. Këto fjalë çanë si thëllim i akullt e tërroqën vëmendjen e të gjithëve në atë çast, kur asgjë s'na bënte përshtypje.

Te porta e dhomës së ushtarit u gjend një burrë i gjatë me qeleshe të bardhë, me sy të murmë e të futur thellë.

— Tujtjetani burra!

— Njatjeta, njatjeta, — ju përgjegjën zëra të mbytur.

Pasi u hodhi një shikim mjekëve, karriges ku kishin lënë rrobat e ushtarit dhe bustinën me yllin e kuq, ju afroa krevatit të ushtarit. Në dorën e tij të madhe që i ngjante një bujashke lisi, mori atë të ushtarit. Asgjë nuk pipëtinte në dhomë.

— Si po më je, or çun... apo je ma mirë, — e pyeti ai ushtarin.

Ushtari i hodhi sytë aparatit, që ishte vendosur pranë krevatit nga ku i futnin gjak në trupin e tij, pastaj shikoi plakun që ishte përkulur mbi të.

— Kush... kush je ti?

— Babai i shoferit, bir!

— Ku është ai?

— Këtu, këtu është.

— Dua ta shoh, nuk e kam parë, belbëzoi ushtari.

Plaku u kthye nga dera. Me nofulla të shtrën-guara e me vetullat e rrudhura si të shtrydhëtë hidhërimin, hodhi sytë në dhomën karshi ku kishin shtrirë djalin e tij. E kaloi korridorin me dy hapa dhe ju afroa djalit. Dhomë ishte mbushur me civi-

la e ushtarakë, po askush nuk mori kurajë t'i thoshte plakut qoftë dhe një fjalë. Ai po e shikonte pamjen e shfytyruar të të birit. — Qenke prishur pak, o bir... poo... nuk po di ende në je vra me turp... apo ke dekun me nder.

Fjalët e plakut të hidhëruar më sollën në vete, m'u futën në shpirt e më kujtuan legjendat për qëndrimin burrëror të prindit shqiptar, kur mëson lajmin se djali është vrarë për atdheun, a për njerëzinë.

Plaku u përkul dhe e puthi djalin, gjatë, në ballë. Në atë çast një djalë i ri në krah të tij ja dha të qarit me dënesë. Plaku u kthye prapa i ngrysur dhe pyeti me një zë që tingëlloi si të dilte nga një shpellë.

— Kush e ka futë këtë grue këtu?

Pas pak shoferin e futën në arkivol dhe e nxuarën nga spitali, në hyrje të të cilit ishin grumbulluar shumë maqina. Qenë shokët e shoferit që kishin mësuar vdekjen e tij.

Gjatë natës bora kishte shtruar ndonjë pëllëmbë mbi qytet, po koha ishte e hapur në mëngjerez. Mbi kokat tonë gjëmoi uturima e dy helikopterëve që çanin drejt veriut...

Casti i nisjes së viktimës do të më mbetet si një kujtim i paharrueshëm gjatë gjithë jetës.

Plaku e shpuri të birin deri në maqinë, pastaj thirri të vëllanë pranë dhe i tha: «Digjo këtu! Çoje Xhemalin në shtëpi. Mos len grue të ulurijë... U thuej njerëzvë se çuni nuk më ka turpnue. Poro-siti çunat të mos ligshtohen... qëndroni si të jem vetë aty... unë... do të qëndroj me këta shokët. Ushtari asht randë por, ndoshta do të na jetojë... Do të rri këtu, të paktën sa të vijnë dhe prindët

e tij.» Ai bëri nja dy hapa drejt derës së spitalit  
dhe foli me zërin e thellë që e prishi përsëri hesh-  
tjen që kishte vendosur vetë:

«Mos e varrosni çunin pa ardhë unë».

— Shoferi ndërpreu një çast tregimin, për-  
shëndeti një djalë të shëndoshë me xhaketë meshi-  
ni që u fut në kafe dhe vazhdoi sërisht:

— Kjo ishte historia e qafës së malit. Kanë  
kaluar dy vjet prej asaj dite, po të gjitha këto që  
tregova, më duken sikur kanë ndodhur dje...

Sa herë kaloj në këtë rrugë sjell me vete një  
dorë lule për shokun e rënë. Unë rrallë kaloj kë-  
tej, kurse shokët e ndërmarrjes ku punonte Xhe-  
mali e kanë të përditshme, prandaj ai lapidar nuk  
mabetet asnjëherë pa lule.

## TË SHKUARA, USTA!

— Mirë mëngjez, usta Vasil!  
— Mirë mëngjez, Sali!  
— Të kam sjellë një ndihmës të ri sot — tha  
Saliu, normisti.

— Ndihmës?! Ore po kjo punë vajti si «gratë e mbretit», mor vëlla. Një ma sjellin për dy muaj, një ikën ushtar, një ikën vetë, një... C'u bëra unë xhanëm? — u përgjegj usta Vasili i pakënaqur. Fytyra e shëndoshë e usta Vasilit, koka tullace e dy sytë e kuq që shikonin pak vëngër nuk e tër-hoqën Qeremin.

«Aha — keq u fillua më duket, do të jetë ndonjë tip i vrazhdë», por përsëri e ngushëlloi vreten: «Jo ore, nuk njihet njeriu me një të parë, kush ua di njerëzve... edhe babai im duket i vrazhdë, por ama ka zemër të mirë». Dhjetë ditët e para ishin të mërzitshme. Ustai nuk i besoi asnjë punë, sado të thjeshtë, ndihmësit të tij. Veten i jepte urdhëra: «Më sill sqeparin, shko merr sharrën, më sill atë limë». Dhe kur shkonte orari i punës, i jepte urdhërin e fundit: «Merr fshesën e pastro repartin!»

Këto urdhëra ndihmësi i kryente me përpik-mëri, por në shpirt ndjehej i vrarë.

Një ditë ustai kishte duart e zëna dhe i tha Qeremit:

— Përvishmi lart mëngët e këmishës. — Kur Qeremi filloi t'i ngrinte këmishën, gishtërinjtë e tij takuan në duart e ngrohta të ustait. Në shpirt ndjeu një kuturisje të çuditshme:

«Pse të mos më besojë ndonjë punë? Të paktën të ngul gozhëdë, të mbërthej ndonjë kapak. Unë jam ndihmësi i tij, ja, qëndroj kaq afër me të. Unë i tregova se në shkollë ne kemi mësuar për punime druri, pastaj... unë isha në aksion, atje kam punuar edhe me sqepar, kur na prisheshin karrocat e dorës Fundja... njeriu mëson duke punuar.»

Mirëpo shpirti i ustait nuk ishte ashtu i ngrohet të si duart. Ai jo vetëm nuk po i besonte ndihmësit, por dhe nuk kujtohej të shpjegonte ndonjë gjë rrëth zanatit. Dhe për ndonjë pyetje që bënte, Qeremi merrte një përgjegje të thatë. Kur u nis rrugës së shtëpisë së tij mendoi t'i thoshte një herë të atit, por sa u ngjit shkallëve ndërroi mendim. «Ndoshta babai do të mendojë se m'u mërzit puna e do të thotë: «Aha... kaq e pat dhe vrulli i tim biri.» Jo, jo... Më mirë të pres një herë. Ndoshta do të kujtohet vetë ustai.»

\* \* \*

Kureshtja dhe dëshira për punë nuk po e linin rehat Qeremin. Prandaj nxori lapsin nga xhepi, mori dhe skuadrën e filloi të shënonte këndet e një kornize. Ustai, që nuk e kishte patur mendjen aty, ktheu kokën dhe i hoqi vërejtjen:

— Të kam thënë një herë, mos zërë gjë mendorë pa lejen time. — Ai i foli me të rëndë ndihmësit të tij dhe, pasi i hodhi një shikim vëngër, shtoi: — Ehu... «Ka dava Janina». Nuk mësohet zanati me urdhër të peshkut, mor birko.

Qeremi u step, e lëshoi skuadrën nga dora dhe uli kokën si i zënë në faj.

— Më fal usta, thashë ta provoja një herë, skuadrën e kam njojur dhe në shkollë.

— Po në film e ke parë? — ju përgjeg us-tai me ironi dhe i ktheu shpinën.

\* \* \*

Në pushimin e drekës Qeremi ja hapi zemrën një moshatarit të tij, që punonte në repartin e rimesos. Shoku e dëgjoi me keqardhje, pastaj i tha:

— Atij, si usta, s'ke ç'i thua. Është një nga më të mirët, prandaj ja fërkojnë një çikë kokën këta të administratës. Po si njeri... është cigun i madh në zanat, nuk ndihmon fare. Nja dy ndihmësa i kanë ikur vetëm për këtë arësy.

\* \* \*

Fjalët e moshatarit të tij e vunë në mendime Qeremin:

«Si të veproj? Të iki dhe unë si të tjerët, apo të duroj vrazhdësinë e ustait?»

Në orën tre dolë i mërzitur nga porta e ndërmarrjes dhe i hipit autobusit. Zbriti në qendër të qytetit dhe u fut kuturu në turmën e njerëzve, që vërzhonin nga të katër anët. Mendja i shkoi

përsëri te fjalët e moshatarit. «Ai është cigun i madh në zanat.» Domethënë konservator? Po, po, bile i regjur. Po si t'ja bëj unë me të? Eh... sikur të ndaloja të gjithë këta njerëz e t'u tregoja: këtu e këtu usta Vasili. A thua do të më përkrahnin, apo do të ecnin përsëri kaq të shkujdesur? Hëm... ç'budallallëqe mendon, or qyq. Gjithsecili ka hallin e tij, se mos i hëngri meraku i usta Vasilit tënd. Shko, ore, nesër në mëngjez e thuaji shefit të të çojë në një repart tjetër» — e këshilloi veten dhe shpejtoi hapat, si të donte të linte prapa mendimet. Por ato nuk i ndaheshin. Atij nuk i mungonte vetëm ndihma për të mësuar zanatin, por dhe kënaqësia që të sjell puna. Ajo kënaqësi, për të cilën njeriu i punës ka aq shumë nevojë. Prandaj, kur u fut në rru-gicën e shtëpisë së tij, ndërroi përsëri mendimin: «Jo. Nuk do të iki prej tij. Atje do të punoj, do të bëj çmos t'ja thyej atë mendim të mykur, se «mos i vjedhin zanatin».

\* \* \*

Në mëngjez, pas leximit kolektiv të shtypit, sekretari i partisë foli dhe për disa probleme të punës, e veçanërisht për kualifikimin e punëtorëve dhe përritjen e rendimentit të punës.

Usta Vasili ishte si në qejf. Veç kësaj, si dukej edhe fjalët e sekretarit të partisë e bënë disi punën e tyre. Kështu që atë ditë ai u tregua më i kujdeshshëm ndaj ndihmësit. I rrahu një herë shpatullat me përkëdheli pastaj i dha një dërrasë të gjerë e të shënuar me laps, për ta prerë me sharrën e dorës. Qeremi e kreu atë punë shpejt e sipas

përmasave të ustait. Ditën tjetër usta Vasili i dha ndihmësit materialet e gatshme, për montimin e një koshi nga ata që përdorin zakonisht nëpër zyra.

Më vonë Qeremi e bëri vetë qysh nga fillimi një kosh të tillë, bile filloi të zdrugonte i sigurtë. «Mjegulla nisi të shpérndahet» mendoi ai, megjithëse ustai nuk e kishte ndryshuar shumë karakterin e tij të vrazhdë.

\* \* \*

Qysh se u fut në punë, Qeremi e vazhdonte shkollën natën. Aty gjeti një ambient krejt tjetër nga ai në të cilin kishte jetuar deri atëhere në bankat e shkollës. Pak moshatarë të tij ishin, pjesa më e madhe e klasës së dhjetë «B» ishin burra e gra, punëtorë me profesione të ndryshme. Në fillim Qeremi e ndjeu veten ngushtë e mbeti i hutuar. Eh, sa rëndë i vinte kur i duhej t'ja thoshte profesorit atë që dikush më parë, gati në moshën e babait të tij, nuk e dinte. Por kjo gjendje qe e përkohshme. Ai u mësua me atë shoqëri të re shkollarësh. Aty ai u njoh me specialistë, racionalizatorë, brigadierë e përgjegjës repartesh që, ndonëse të thyer nga mosha e nxënësit, përpinqeshin me gjithë shpirt përt'u preqatitur sa më mirë.

Një natë, kur një tornitor u ngrit dhe kritikoi mësuesen e gjeografisë për shpjegimin formal të lëndës, Qeremi mbeti i habitur: «Po ky mo, është në vete apo jo? Kujton se është në pesëminutëshin e repartit. Ajo të gjen rastin dhe të këput një katersh që të vish me freskllëk në vjeshtë» — mendoi me vete.

Mësuesja u ngrit nga tryeza e saj dhe po i afrohej bankës së fundit, ku ishte ulur tornitori. Qeremi po e shikonte atë si të mos e kishte parë kurrë.

— Kini të drejtë, shok... Nuk jam precatitur mirë. Sot nuk kam qenë mirë me shëndet, jo se ju nënvliftësoj ju... Mos ma merrni për keq — i tha ajo tornitorit.

Në klasë ra një heshtje e thellë. «A thua se dhe usta Vasili do t'i jepte përgjegje të tillë kritikës sime për qëndrimin e tij konservator — mendoi Qeremi me vete. — Jo, jo... nuk e besoj kurrë. Mësuesja ka qenë vetëm sot ose dje e sëmurë, kurse usta Vasili vuau nga një sëmundje e vjetër kronike, që do ilaqe të fortë për tu shëruar».

\* \* \*

Përkrahja që i dha usta Vasili ndihmësit të tij që e përkohshme. Shpejt ai u mbyll në guackën e vet Megjithatë, Qereuni nuk linte rast pa shfrytëzuar për të bërë vetë ndonjë punë. Një ditë që ustai po montonte faqet e një komodine, Qeremi mori trapanën elektrike dhe shpoi vrimat e dorezës së kapakut. Mirëpo për fat të keq vrimat i shpoi pak larg dhe, kur po fuste me zor dorezën metalike, kapaku u çा.

— Oh... foli ndihmësi dhe diçka murmuriti me vete i shqetësuar. Ustai ktheu menjëherë kokën.

— Ç'pate, more?

Qeremi i lroi vend mjeshtrit. që të shikonte gabimin e tij.

— E theve? — bërtiti ustai.

— U ça pak, usta.

— Po pse, ore, t'u çuftë koka, kush të tha përatë punë, xhanëm. Të kam thënë njëqind herë të mos zësh gjë me dorë. Tutje që këtej — i briti ustai, duke e shtyrë me bërryl dhe duke i marrë kapakun.

— Na u bëre usta zotrote — vazhdoi nervoz. — E kur u bëre? Ke dy muaj e gjysmë dhe mezi na bëre një kosh mbeturinash.

Këtu Qeremi nuk u përbajt më dhe ja ktheu:

— Që nuk kam bërë gjë më të madhe se koshi i mbeturinave, nuk është faji im.

— Po i kujt është, more bilbil?

— Është juaji, që nuk më shpjegoni asgjë. Ruheni se mos ju vjedh zanatin.

— Ahaaa... të paskam prerë hovin, ë? Mooore, na fal, na fal, shoku ndihmës, por ja ku po të them se zanati nuk është akullore. Unë kam punuar tre vjet me italianin Karmelo qysh në mëngjez e në darkë, haja dhe pëllëmbën turinjve ee... mezi, pas një viti, më lejoi të bëja një valixhe.

— Këto i di nga shkolla dhe nga babai im — ju përgjegj Qeremi i revoltuar. — Por unë sot nuk mund t'ju krahasoj ju me italianin Karmelo. Ai ishte më shumë pushtues për ju, se sa usta. Prandaj unë nuk mund ta pres zanatin nga ju, ashtu siç e prisnit ju nga ai. Ne jetojmë në një kohë të re, ju jeni për mua si babai im. Karmelojt kanë kohë që u gremisën në det, kurse ju akoma me atë avazin e mykur. Për mendimin tim, do të kishit bërë mirë që si përgjegje të pëllëmbës, t'i kishit dhënë atij Karmelos një çekan kokës. Ashtu do t'ju këndohej

dhe ndonjë këngë. Kurse kështu kini mbetur një konservator, ndaj nuk qëndron ndihmës me ju.

Usta Vasilit ju skuqën flakë sytë e vëngërt e gjaku i hipit në tru.

— Si the, ai?.. Shko këtej e mos më çaj veshët tër-tër, paske marrë informata ti? Thyej qafën këtej, e mos të të shoh më në repart!

— Ju falemnderit usta, por mos kujtoni se reparti është juaji — ju përgjegj Qeremi duke dalë.

— Oj... ke parë kështu ore? Çunaku me buzë në qumësht të të bëjë dhe politikë.

«Eja baba, të të tregoj arat e malit» — foli me vete usta Vasili dhe e hodhi tërë nervozizëm kapakun e çarë mbi tryezën e punës.

\* \* \*

Të nesërmen Qeremi ngjiti shkallët dhe u fut në zyrën e shefit të repartit të zdrukthtarisë.

— Hë, mor djalë, ç'kemi? — pyeti shefi pasi ngriti sytë nga disa shkresa të hapura mbi tryezë.

— Kam dashur të viaj dhe më parë te ju, shoku shef, por... mendoja se çdo gjë do të rregullohej pa ndërhyrjen tuaj... — Dhe i tregoi Qeremi shkurtimisht rrëth qëndrimit të usta Vasilit.

— Po pse, mor djalë, t'ca kapaku i komodinës?

— Unë u mundova për mirë, shoku shef, pastaj ai nuk doli jashtë përdorimit...

— Sidoqoftë, gabimi u bë — e ndërprenë shefi për t'i tërhequr vërejtjen, pastaj vazhdoi: — Usta Vasili është pak nevrik.

— Unë nuk e kam hallin të nervat, shoku shef,

por dua të më ndihmojë. Ai nuk të jep zanat, ai  
është një konservator i regjuar... — nisi të fliste  
Qeremi i rrëmbyer.

— Ha-ha-ha — qeshi i kënaqur shefi — shpir-  
to jeni ju të rinjtë për ideal. Si të quajnë?  
— Qerem.

— Ashtu?.. Dëgjo Qerem: deri diku janë të  
vërteta ato që thua, megjithëse ti tashti je i shqetë-  
suar e s'mund të arësyetosh drejt po... ashtu është,  
usta Vasili, ka ndonjë lakër në kokë nga ato të  
vjetëruarat, që duhen luftuar si fenomen i dëm-  
shëm në shoqëri — nisi zyrtarisht shefi — por ama  
është një specialist i zoti.

— Poo, dhe që të mësosh ndihmësin dhe të  
kualifikosh njerëz të rinj, është një gjë e dobish-  
me, që duhet bërë, shoku shef.

— Po, po, ashtu është, por dhe s'duhet vënë  
majë më majë për ca gjëra, bre Qerem. Ti je djalë  
i ri, dhe në të bërtiti pak ustai, fundja, hapi rrugën  
dhe..

— Unë nuk e kam hallin e të bërtiturave, sho-  
ku shef.

— Mirë, more djalë, po sidoqoftë...

— Por ai...

— Mirë, mirë, do ta shikojmë nesër këtë — e  
ndërpreu shefi, duke i lënë përshtypjen Qeremit  
se duhej të dilte prej zyrës.

Biseda me shefin e mërziti më shumë Qeremin,  
ndjeu se po e lëshonin forcat. Moshatari i tij, që  
punonte në repartin e rimesos dhe që tanimë i ishte  
bërë shoku më i afërt Qeremit, i kishte thënë se  
usta Vasilit ja mbante shumë hatrin shefi. Këto i  
vërietoi ndihmësi prandaj, kur po zbriste shkallët

me hapa tē rëndë, mendoi me vete: «S'ka faj usta Vasili, fajin më tē madh e kanë shefa tē tillë, që e luftojnë tē vjetrën vetëm me fjalë zyrtare».

\* \* \*

E shoqja e usta Vasilit ishte nga ato gra, që e njohin me rrënjë karakterin e burrit tē tyre prandaj, në kohën që i shoqi po hante darkë i menduar, ajo e pyeti kureshtare:

— Sikur nuk tē shoh në terezi sonte, mor burrë, ç'ke kështu?

— Jo, nuk kam ndonjë gjë, jam lodhur ca sot — ju përgjegj usta Vasili pasi mbushi gotën e dytë...

Në tē vërtetë nuk ishte lodhja që e kishte bërë tē menduar atë natë ustanë, por grindja me ndihmësin e tij.

— Dreq o punë... një çunak tē këput një thumb që s'të zë as gjumi» mendonte ai. «Ti nuk je Karmelo italiano pér mua... je babai im....». Sado që usta Vasili mundohej t'i hidhkte tej mendimet e ditës, ato s'donin që s'donir t'i dilnin nga mendja. «Mos tē vjedhë zanatin djali yt?..»

«Kishte tē drejtë... po, po... Tashti është kohë tjetër... Ai është pjella e kësaj kohe... Eh, moj kokëndryshkur... Nesër duhet ta marrësh prapë në repart... do tē tē dalë boja në pleqëri...» — Kështu i mbylli mendimet usta Vasili atë natë.

\* \* \*

Mëngjez. Në orën tetë usta Vasili ngjiti shkallët e administratës dhe u fut në zyrën e shefit.

— Urdhëro, usta Vasil — ju përgjegj brigadier i repartit të rimesos, që në mungesë zëvendësonte shefin.

— Kisha pak punë me shokun Kristaq.

— Nuk është këtu, ka shkuar me shërbim në Laç në kombinatin e drurit, por... nëse mund të t'ë ndihmoj... C'hall ke?

— Jo more, çfarë halli po... më kanë marrë atë ndihmësin...

— E kanë marrë apo e ndoqe vetë usta — i tha zëvendës-shefi duke shikuar nën vetulla.

— Pooo... si të them, ai bëri një gabim, dhe unë u nevrikosa një çikë ee...

— Atë e dërgova në repartin e rimesos, sipas urdhërit të shefit. Tashti nuk di si të them... Fundja, në qoftë se ti e do, shko merre vetë dhe bisedoj unë prapë me shefin.

Usta Vasili mbeti i zënë ngushtë. Doli pa folur nga zyra, zbriti i rënduar shkallët dhe mori tutje korridorit të ngushtë, për në repartin e tij...

\* \* \*

Në repartin e rimesos Qeremi gjeti një ambient tjetër. Moshatari i tij e priti i kënaqur dhe e prezantoi me usta Xhemalin.

— Mirë se erdhe, more aksionist — i foli me buzë në gaz ustai i ri.

— Mirë se ju gjej usta.

— Hë? Si e kalove me usta Vasilin? A ja more ndopak dorën zdrukthit? — e pyeti Xhemali qëllimi, ngaqë e kishte marrë vesh çështjen prej zëvendësshefit.

— Zdrukthit jo dhe aq, pasi e kishte zënë vëtë ustai — ju përgjegj Qeremi me sinqueritet.

— Mirë. Këtu do të punosh bashkë me shokun tënd. Unë do t'ju ndihmoj. Për çdo gjë më pyesni mua pa drojtje. Por ama, dua punë vec ë?

— Mos ki merak, usta — u përgjegj Qeremi i gëzuar.

\* \* \*

Usta Vasilin e kishin shtruar urgjent në spital, pas një krize të rëndë që i kishte filluar në punë. Ditën e pestë gjendja e tij kishte filluar të përmirësohej dhe mjekët kishin lejuar vizitat e njerëzve të tij dhe të shokëve të punës.

Të nesërmen nga ora pesë pasdite u hap dera dhe në dhomë u fut ndihmësi i tij. Usta Vasili sapo kishte mbyllur sytë. Qeremi ndali te këmbët e krevatit të tij dhe po e shikonte me aq vëmendje, si kur të mos e kishte parë prej kohësh.

«Sa keq që e gjeta në gjumë» — mendoi me vete.

C'të bënte Qeremi? Ta linte mbi komodinë atë pakon e vogël që shtrëngonte në duar dhe të dilte pa folur? Nuk i vinte mirë, po dhe që të priste derisa të zgjohej ustai, nuk kishte kohë. Mjeku i rojes i kishte dhënë vetëm një gjysmë ore leje. Prandaj pyeti me zë të ulët të sëmurin tjetër:

— Më falni... ka shumë që fle ky?

— Jo more djalë, zgjoje, se tashti sa i mbylli sytë.

Ndërkohë usta Vasili i hapi sytë dhe shikimi i tyre ndeshi në ata të Qeremit. Përpëliti një herë

qepal'lat, rrudhi vetullat dhe pasi i hodhi ish-ndihmësit të tij, një shikim të gjatë, nga koka te kembët, i foli:

- Qeremi!?. dhe ti erdhe, mor djalë?
- Po, usta, erdha të të shikoj... pse të mos vija?
- Eh... — bëri usta Vasili si i zënë ngushtë. — Falemnderit, bir, falemnderit. Eja ulu — i tha ai i mallëngjyer dhe u mat t'i hidhte dorën në qafë...
- Mos... mos luaj, usta, ja po rri këtu unë — i tha Qeremi dhe u ul në buzë të krevatit.
- Po si je, mor bir, si janë shokët?
- Mirë, usta, po ti si je, a je më mirë?
- Qeremi vuri pakon me fruta mbi komodinë, kurse nga xhepi i xhaketës nxori një kornizë të vogël e të llustruar me kujdes të veçantë dhe ja zgjati ustait:
  - Të kam sjeillë dhe këtë, usta... si kujtim nga duart e mia.
  - Vetë e ke bërë, more Qerem? — e pyeti ai duke zgjatur dorën i çuditur.
  - Po, usta, që nga fillimi në fund.
  - Të lumshin duart, jaa... sa mirë! Tamam punë me ustallëk — fliste usta Vasili si me vete, duke shikuar kornizën sa në një anë në tjetrën, si të qe një detal i panjohur për të.
  - Të falemnderit, Qerem... do ta ruaj këtë kornizë nga ti, po vë fotografinë time në të.
  - Do të rrish dhe shumë në spital, usta?
  - Poo... të shohim, këta mjekët nuk para tregojnë, por sidoqoftë duhet të rri dhe nja dhjetë ditë akoma.
  - Mos u mërzit, usta, mos u nxito të dalësh pa

u shëruar mirë. Tani do të më falësh, usta Vasil. Kisha qejf të rrija, po mjeku më ka dhënë vetëm gjysmë ore leje.

— Mirë, bir... të shkosh... nuk ka rëndësi se sa ndeje... ti e bëre tënden... — i tha usta Vasili i mallëngjyer dhe e përqafoi.

Kur Qeremi ju afrua derës, ustai i foli me një zë që dhe vetë atij ju duk i huaj:

— Qerem!

— Urdhëro!

— A do të vish në repartin tim kur të dal nga spitali?

— Shërohu, usta shërohu një herë sa më mirë...

— Do të shërohem, pos!

— Të shkuara, usta. Mirë u pafshim!

## GJEMIMET E PARA

Tej nga rrëza e kodrës vinte rrapëllima e mërzitshme e centralit elektrik. Nata kishte rënë mbi qytetin e heshtur. Në qiellin e kthjellët vezullonin si të nemitur yje të rralla. Tutje nga mesi i lagjes lehte një qen me zë të hollë, të çjerrë e të dhimbshëm.

Në rrugicën e errët të kufizuar me ca kallama të gjatë, ata të dy ecnin pranë njëri-tjetrit, ngadalë, të heshtur e të menduar.

— Kështu, Donika — e prishi heshtjen ai. — Nesër në mëngjez nuk do të takohemi dot... Ndarja mund të vazhdojë gjatë... kjo varet... se si do të zhvillohen ngjarjet. Megjithëse unë kam besim që do më shkojë mbarë.

Përsëri heshtje. Ecën ashtu një copë rrugë, pastaj ajo u ndal, e zuri për dore dhe duke u përpjekur të fshihte prej tij sytë e përlotur, i tha:

— Kthehem i edhe një herë; ju afruam shtëpisë sime... Si do të bëhet nëse punët do të shkojnë keq?... Kjo do të jetë e tmerrshme... sikur të ishim bashkë të paktën, do të isha gati të vdisja dy herë.

— Kurse unë për çështjen tonë të madhe do të vdisja disa herë — i tha ai.

— Ashtu është — ja ktheu ajo si e zënë në faj. — Mos kujto se jam trembur. Tani unë jam e vetëdijshme pér çdo gjë. Ne kemi biseduar disa herë, e kemi thënë se dashuria jonë do të lulëzojë nesër... Por... si të të them, e kam të vështirë të përfytyroj një ndarje fatkeqe e kaq shpejt... Nuk mund të harroj pér asnjë çast se nesër ty të duhet të rrish gjë më gju me vdekjen!..

— Jo, Donika, mos ki merak. Poo... pse të flasim pér këtë, pse të mendojmë të keqen? Unë jam i bindur se çdo gjë do të shkojë mbarë. Ja, ke pér të parë — i dha zemër ai dhe pasi i shtrëngoi dorën, e afroi pranë vetes. Ajo mbështeti kokën në gjoksin e tij të fuqishëm dhe humbi një çast e lumturuar në mjegullën e shpresave të mira. Nisën të ecnin, u kthyen sérishmi dhe pranë gardhit të shtëpisë së saj të vogël mezi i ndanë duart.

— Mirë u pafshim, Doni, mos harro porositë e mia!

— Mirë u pafshim, Shyqo. Dije se do të më kesh pas gjurmëve të tua — i tha ajo dhe humbi në errësirën e kopshtit.

Ishin muajt e parë të dashurisë së tyre; ishte ajo kohë, mbresat e së cilës nuk harrohen lehtë, gjatë gjithë jetës. Ishte si të thuash mituria e dashurisë së tyre, e përzier me detyrat e mëdha të kohës. Ndoshta ata do të vazhdonin ashtu në shëtitje gjithë natën, por kjo ishte e pa mundur, prandaj dhe u ndanë...

Shyqyriu pasi u nda me të fejuarën, kaloi rrugën e dekovilit, u fut nëpër kopshtet e lëna djerr e me gardhe të rënuara dhe u ngjit shkallëve të shtëpisë. Ndaloj një çast në krye të shkallëve.

hodhi një sy tej mbi qytetin e zymtë e të heshtur, dëgjoi ato zëra të përzier të natës, pastaj ca hapa të rëndë në rrugicën me kalldrëm, nga prapa shtëpisë së tij. Afroi kokën për të dëgjuar në kishte ndonjë mysafir atë natë, po nuk dëgjoi zë. Me siguri që nëna e priste si zakonisht, e merakosur.

Mendimet rrith së fejuarës u zëvendësuan nga mendime të tjera.

«Ki kujdes, Shyqo, nuk është gjë e thjeshtë. Matu, matu mirë, pastaj vepro. Çdo pakujdesi, ka të bëjë me jetën tënde dhe të njerëzve që punojnë rrith teje. Ka të bëjë me gjithë shokët e tu, që të presin me dashuri».

Këto kujtime të disa orëve më parë e ndalën. Nuk i ra derës, por u ul me kujdes në prak.

«Epo fundja, një herë kemi lerë e një herë do të vdesim, e aq më tepër kur rasti po më ofron një vdekje të tillë».

«Jo — jo... në asnje mënyrë. Në kohën tonë asnje shok nuk duhet të vdesë kaq lehtë:jeta e secilit prej nesh tani i takon popullit e atdheut. Mos harro, jetën tënde e ke të përbashkët me ata hamejtë, që rënkojnë nën peshën e vuajtjeve, rrith teje.

Vetë rrethanat, pamundësia që të futim një shok për të të ndihmuar ty, në portin ushtarak na bën të përkrahim zotimin tënd për kryerjen e këtij misioni të rëndë».

«Mos kini merak, shokë, nuk do të harroj asgjë nga porositë tuaja. Kam besim se punët do të shkojnë mirë».

Fillin e mendimeve ja ndërpren uturima e një aeroplani që vinte tej nga deti. Dëgjoi një çast, ngriti pastaj dorën dhe i ra derës.

— Po ku ishe, mor bir i nënës? Ç'bën deri në këtë kohë jashtë?... Ma bëre gjakun ujë, ma bëre.

— Ç'ke, moj nënë, gjithmonë me ankime të shkretë — i tha ai me dashuri së ëmës dhe e mori për qafe. — Nuk ka asgjë të keqe, pse bëhesh merak?

Nënë Aisheja e shikonte atë djalin si dritën e syrit. Ai ishte i vetmi gëzim për të. Në qytet ndodhnin përlleshje dhe arrestime nga ushtarët italjanë, prandaj ajo tronditej për të. Nëna e priste gjithmonë, deri vonë, derisa të vinte. Donte të hante së bashku me të, ta shihte e të lumturohej me djalin e saj të vetëm.

Shyqyriu u mundua të hante bukë fare i qetë, bile duke dashur të tregonte se kishte oreks, por nuk i hahej.

Nënë Aisheja e kuptonte mejëherë djalin e vet. Atje, në sytë e tij të zjarrtë, nën ato vetulla të dendura e të gjata, në buzëqeshjen që ai e kishte si të përhershme në fytirë, ajo sikur shihte shpirtin e tij. E njihte atë, ashtu siç njeh delja në qindra shqerra zërin e qengjit të saj.

E, ndërsa ajo po e shihte me bishtin e syrit, ai e prishi heshtjen:

— Ha bukë, nëno, përse mendohesh?

— Jo a të keqen, pse të mendohem, ja, vetëm për ty kam merak unë.

— Kot e mundon veten, për mua s'ka asnje të keqe. Shyqon do ta kesh gjithmonë pranë.

Pas buke ai u nda me të ëmën dhe u fut në dhomën e tij të vogël e me tavan të ulët. Në dhomë bënte shumë vapë. Ishte shumë e nxehjtë ajo natë gushti. Disa mushkonja që ishin strehuar aty me

kohë, u lëshuan menjëherë drejt llambës dhe nisën vallen duke zukatur.

Si u ul mbi krevat, zgjati dorën poshtë tij dhe nga një valixhe e vogël nxori një copë të madhe eshke. Hoqi një thelb, e ndezi dhe e la para vetes mbi tryezë. Nxori orën dhe nisi të ndiqte me sy akrepin e sekondave.

Kaluan kështu rreth njëzet minuta. Eshka u dogj. Ai ndezi një tjetër më të madhe, në fund të saj la kokën e një shkrepseje. Humbi shikimin në një pikë të pacaktuar dhe ndeji ashtu i zhytur në atë mendim. Kur zjarri arriti fundin e eshkës, shkrepseja u ndez me zhurmë. Ai shikoi orën me një buzeqeshje gjithë kënaqësi dhe u shtri mbi krevat, ashtu siç ishte. Kishte qejf të flinte, të bënte një gjumë të mirë atë natë, prandaj i shtrëngoi sytë dhe ua mbylli rrugën mendimeve.

Në mëngjez u ngrit shpejt, mori atë trastën e bukës që merrte gjithmonë, e puthi të ëmën duke u shtirur sikur e bënte këtë ashtu kot fare, siç e kishte zakon nganjëherë.

— Ditën e mirë, nëno!

— Mirë u pafshim, bir i nënës — ja ktheu ajo duke shikuar nga pas me dashuri trupin e zhdërvjetëllët të djalit të saj.

E ku ta dinte ajo se ç'bluante në mendje ai atë ditë?

Në anë të xhades i hipi maqinës, që zakinisht merrte punëtorët e portit ushtarak dhe u nis në vendin e punës.

Sipas porosisë së udhëheqjes së grupit komunist, Shyqyriu kishte kohë që ishte futur si punëtor në portin ushtarak fashist. Në jugperëndim të fshatit

Radhimë, pushtuesit fashistë italianë kishin ngritur zonën ushtarake të armatimeve. Tunelet në kodrat aty pranë, magazina e depo ishin mbushur plot e përplot me armatime nga më të ndryshmet. Trinçea dhe sheshi përreth u mbushën me mijëra arka dinamiti, baruti, fishekësh e bombash. Puna në port nuk pushonte gjatë gjithë ditës. Sa vinte dhe togu i arkave të munitioneve nisi t'i ngjante një kodre të vërtetë. Shpesh mendonte Shyqyriu për atë fuqi shkatërruese dhe mendimet i përziheshin, parafytyronte ato uzina të panjohura, ku prodhohej ai zjarr përvëlues për njeriun. Madje çuditej se si punonin, kush punonte e pse punonin atje njerëzit, për të prodhuar vdekjen! Por shpejt i hidhte tej këto mendime dhe të tjera, më të qarta e objektive ja zëvendësonin. Atij nuk i shpëtonte asgjë nga materialet që zbarkoheshin aty. Shpejt numrin e tyre dhe llojin e mësonin pastaj dhe shokët e Shyqos, që në fshehtësi pregatisnin zjarrin e madh rrëth fashizmit. Atë ditë, orët që i dukeshin tmerrësish të gjata. Mendimet nuk e linin rehat, por ai vazhdonte të punonte së bashku me to.

«Më duket se ky është një veprim i nxituar, Shyqo; kam frikë se do të ndodhë gjë. Me sa dihet; ato armatime do të tansferohen për në jug të Shqipërisë. Ata do t'i përdorin kundër Greqisë, me të cilën tanimë janë mpleksur keqas».

«Jo, nuk është aspak i nxituar. Ata i kanë zbarkuar këtu jo pa qëllim. Duan të trembin popullin tonë, që të qëndrojë i gjunjëzuar e i bindur ndaj skllavërisë që i scelli mbreti. Në rastin më të parë ato do të përdoren kundër popullit. Edhe sikur në jug të shkojnë; a nuk do të vrasin njerëz atje; a

nuk është dhe greku një popull, që ashtu si edhe ne, kërkon të mbrojë lirinë e vet? Ne, njerëzit e idealit komunist, duhet të mendojmë jo vetëm pér një qëllim të ngushtë, por edhe pér lirinë e njerëzimit».

Këto mendime i kujtuan Shyqos shkollën trejtare, ku gjatë dy vjetëve kishte formuar karakterin e tij. Atje ai kishte takuar shokët më të mirë, kishte njojur demostratat; revoltën e studentëve kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Atje ai i njoihu ata shokë, që i rrënjosën idealin e lartë.

\* \* \*

Në orën dy, punëtorët u mblozhën te hija e shelgut pér pushimin e zakonshëm të drekës. Aty pranë tyre, më këmbë, rrinin dy ushtarë italianë dhe nën oficeri i rojës, një bukurosh me pantallona të shkurtëra meshini. Pikërisht në atë çast Shyqyriu ju afrua shokëve me duart e shtrënguara në bark e i përkulur nga dhimbja.

— Ç'ke kështu, more? — e pyeti kryepunëtori.

— Oh... nuk e di, një dhimbje po më therr si thikë në bark... Kam gati dy orë... Po, ja... mezi duroja.

— E çec do kesh ngrënë, a lumëzi — tha një shok tjetër, që ishte në dijeni të çështjes dhe që do ta ndihmonte, po të ishte nevoja, pér të kryer me sukses këtë aksion të rëndësishëm.

— Nuk po qëndroj dot — vazhdoi Shyqyriu me fytyrë të deformuar. — A të shtrihem në ndonjë hije se mos qetësohem ca... Si duket nuk mund të punoj më.

— Po ku tē dhemb ore, mos ēshtë zorra e verber? — e pyeti kryepunëtori.

— Jo, jo... — ju përgjegj ai me nofullat e shtrënguara. — Më dhemb në krahun e majtë.

Le tē shtrihet në ndonjë anë, s'qenka hiç mirë, — foli prapë shoku.

— Po mirë, ikë e shtrihu aty në ndonjë hije — i tha kryepunëtori pa e çarë kokën fare.

— Che cosa ha egli ragazzo? (Çfarë ka ai djalë?) — Pyeti nën oficeri pasi e hoqi muzikën nga goja.

— E amalato signor (Ēshtë i sémurë, zotni) — ju përgjegj kryepunëtori, ndërsa roja e futi përsëri muzikën në buzë dhe u nis drejt barakës së tyre, së bashku me tē dy ushtarët. Punëtorët nisën tē hanin drekën. Shyqyriu mori anës së detit i kërrusur dhe u shtri nën hijen e një verrishteje. Mbylli një çast sytë dhe pasi e mbledhi veten mendoi: «Eh, kaloi prova e parë».

Përpara tij shtripej deti i qetë e i ndritshëm. Tej, Sazani i ngjante një gjiganti, që ishte shtrirë për tē ngrohur kurrizin në diell. Në anën tjetër Karaburuni zbriste i madhërishëm nga mali i Çikës si për tē marrë ujë tē kripur.

Shyqyriu e donte shumë detin, malet, e donte atdheun e tij, i donte njerëzit e thjeshtë e tē varfër; po tanë tē gjithë këta i dukeshin tē zymtë, tē heshtur, tē mjerë, tē shkelur nga një këmbë e huaj.

Për tē gjitha këto zuri ta vriste mendjen atje, nën hijen e verrishtes, karshi detit tē pafund, me dorën bërryl tē vënë në kokë.

Pas ndonjë ore shokët ja nisën punës së rishmi dhe ai u ngrit më këmbë e doli në një vend tē dukshëm, me duart në bark.

— E-e-e-e? — i briti kryepunëtori nga larg.

Kurse Shyqua u tundi kokën sikur të ishte në pikë të hallit dhe u shtri përsëri pak më tutje.

Aty nga ora katër e ca, u ngrit ndenjurazi dhe shikoi me vëmendje përreth. Territori ushtarak përfshinte gati dy kilometra katrose, prandaj rojet fashiste rrinin larg, në disa nga pikat më strategjike. Pranë punëtorëve, zakonisht, rrinte nën oficeri bukurosh ose zëvendësi i tij dhe kryepunëtori.

Pak më larg nga verrishtja ku ishte shtritur Shyqyriu, ishte rezerva e barutit, pastaj vinte dinamiti, bombat e pas tyre armatimi i rëndë.

Pasi shikoi edhe një herë nën oficerin italian, kryepunëtorin dhe më tej grupin e punëtorëve në mes të të cilëve dallohej shoku i tij besnik, nisi t'u afrohej me guxim arkave të barutit.

«Ki kujdes... matu, matu mirë...» — i erdhën në vesh porositë e shokëve. U ndal një çast, kontrolloi dhe një herë përreth dhe, pasi kaloi një gëmu-shë të madhe e të gjelbëruar, u gjend pranë togut të madh me arka. U shtri atje, kontrolloi sérishmi. Nxori nga gjiri një thikë të vogël dhe nisi të gërryeante me të midis dy dërrasave të tendosura të një arke të zezë.

Pas një copë here të gjatë, thika me atë majën pakëz katrore e bëri punën e saj. Në grykë të vrimës së hapur u duk një «relikë» baruti.

«Aty, aty rri, se nuk më duhesh tashti, eh, bukuroshe e vogël e ardhur nga larg. Me ty do t'i zgjoj nga gjumi gjithë shoqet e tua, po prit dhe pak» — i tha ai kokrrës së barutit dhe e shtyu brënda, si të ishte një qenje e gjallë.

Përtej, nga roja në jugë, dëgjoi një të bërtitur dhe pas saj zëra.

«Jo, jo. Në asnje mënyrë. Në kohën tonë asnje shok nuk duhet të vdesë kaq lehtë...» — i erdhën papritur në kujtesë porositë e shokëve. I largoi mendimet. Afroi me të shpejtë pranë arkës një dorë bar dhe zhduku gjurmët e tallashit të grirë nga arka. Toka i solli një zhurmë të mbytur. «Si duket do të më kenë parë. Atëhere s'ka si bëhet ndyshe, çdo gjë të gjejë vendin e saj. Mjaft që pas meje të vdesë robëria» mendoi me vete dhe nxori shkrepsen nga xhepi.

Ai ishte tip i çuditshëm. Herë i qetë e herë i durueshëm, herë i rrëmbyer e i papërmbajtur. Një gjë kishte të padiskutueshme në natyrën e tij: atë që merrte përsipër do ta shpinte në fund, patjetër. Për frikacakët ai ushqente një përbuzje të hapur. «Ai që ka frikë, bën mirë të mos dalë nga konaku, ai nuk mund t'i shërbejë kurrë shoqërisë» thoshte ai shpesh. Ashtu me shkrepsen gati e me sytë katër priti një copë herë. Zhurma, tej nga roja, u shua. Nxori orën nga xhepi dhe e pa. Eh, sa ngadalë shkonte ajo e shkretë.

«Duhen akoma dhe dyzet minuta që të lihet puna» — mendoi. Priti ashtu në rrjetën e mendimeve të shqetësuara. Nxori përsëri orën.

«Eh, edhe dhjetë minuta! E do të bjerë fisha...» — mendoi i gjallëuar. Kontrolloi një herë mirë e me kujdes të gjithë territorin sa e zinin sytë. Nxori nga gjiri një thelb eshke të thatë, të zgjedhur, të matur e të mbështjellë me aq kujdes. E futi në vrimën e arkës. Një ndjenjë gjëzimi e përzier me shqetësim, e paprovuar ndonjëherë, i vërshoi në

shpirt dhe ju duk sikur do t'i zinte frymën. Tej nga pozicionet e armatimit të rëndë, ra fisha përmbarimin e punës.

«Ja, erdhi ora, erdhi... eh, më vaftë mbarë...» — foli me vete i ngazëllyer e gati me zë. Nxori shkrepsen dhe e ndezi eshkën e mbetur jashtë. E kishte llogaritur ditë me radhë, atje në dhomën e tij se, derisa zjarri t'i shkonte eshkës në fund, atje ku ajo takonte me barutin, duheshin plot tridhjetë minuta, kohë e mjaftueshme kjo, për t'u larguar nga territori ushtarak gjithë punëtorët, shokët e tij.

E shikoi edhe një herë veprën e tij i ngazëlluar, si t'i thosh: «punë të mbarë» dhe u nis drejt shokëve, me duart në bark dhe fytyrën të ngërdheshur nga «dhimbja».

Nga shikimi i përqëndruar dhe nga shenja që i dha Shyqua, shoku i tij e kuptoi se gjithshka kishte shkuar në rregull.

Në xhadënë, që kalonte fare pranë zonës ushtarakë, i hipën maqinës e u nisën drejt Vlorës. Kaloi një copë rrugë e maqina mori kthesën e parë pas kodrës në buzë të detit. Shyqyriu rrinte ende me duart në stomak, me kokën të ulur, madje dhe i verdhur në fytyrë.

— E pse nuk ike shpejt, o lumëzi, ke dhimbje shumë? — e pyeti një nga shokët, por ai nuk ju përgjegj. Luajti vetëm kokën.

Shyqua kishte me të vërtetë shumë dhimbje, po jo në bark, në shpirt, në zemer.

«Oh, po sikur... të mos ndodhë gjë?» — mendoi i dëshpëruar dhe nxori me kujdes orën. Kishte ende dhe një minutë a më pak kohë. E futi orën në xhep dhe ju duk sikur futi në mish një copë

thikë. Kaloi edhe minuta, asgjë; qetësi, heshtje varri, ose të paktën kështu ju duk atij. Për pak desh e humbi fare, desh e dha veten para shokëve. Në shpirt ndjente një dhimbje të fortë, që ja pushtoi gjithë qenjen. Ngriti kokën lart dhe padashur i hodhi sytë tej...

Në atë çast një shpërthim e çau si thikë hesh-tjen, u përzje me një bubullimë, ashtu siç pérzihen bubullimat shkatërruese të qiejve dhe oshëtiu maleve anembanë. Maqina mori kthesën e dytë dhe doli përkarshi bazës ushtarake, mbi të cilën vërshonin shtëllunga tymi të përflakura. Vështrimet e të dy shokëve u kryqëzuan.

Me orë të tëra vazhdoi gjëmimi i maleve Baza ushtarake e armatimit italian në Radhimë u hodh në erë. Atë përmasë të jashtëzakonshme vdekjeprurëse e gjallëroi një fitil eshke. Eshkë e thatë e nxjerrë nga një lis i maleve të Labërisë trime. Ky lajm çau si rrufeja retë dhe mori dheun. Për këtë flisnin në kasollet e varfëra. Këtë bubullimë e kishin dëgjuar edhe barinjtë tej Çikës, lebër e himarjotë, për këtë flitej kudo në qytete, në rrugë, në dyqane e zyra.

Në receptorët e telefonave ulerinini agjentët e SIM-it si ulkonja e tërbuar, pasi i kanë djegur folenë së bashku me pjellën e saj.

Jehona e lajmit të këtij grushti të rëndë, të dhënë nga brigjet ku xha Selimi luftoi me dyfek me gjalmë, e kaloi Adriatikun dhe arriti tej, në Romë...

## GABIMI I NJË SHOFERI

### I

Ai kishte filluar të shkëputej nga unë dhe shpesh kur e takoj, më mbyste me erën e alkoolit. Prandaj atë natë vendosa të pres deri vonë. Një ditë më parë më kishte rënë në dorë libri «Kujtimet e shoferit Gil» dhe po më kalonin orët pa i ndjerë. Në rrugën kryesore u rralluan lëvizjet, qyteti po binte në heshtjen e natës. Nga një ndërtesë e lartë karshi hotelit vinte deri në dhomën time melodja e violinës cigane. Pas pak edhe ajo pushoi, e radio Tirana njoftoi mbylljen e emisioneve. Prita ende, derisa akrepat mbuluan njëri-tjetrin mbi orën dymbëdhjetë, po ai nuk erdhi.

Në mëngjez zbrita shkallët e hotelit dhe u futë në kafe. Manoli rrinte më këmbë pranë banakut, me gotën e fërnetit përpara. Përhëndeta banakierin dhe porosita një kafe.

— Si u gdhive, more shok, pse s'më flet? — më tha Manoli, duke më shikuar me bisht të syrit.

— Si në krevat, po ti si u gdhive? — ju përgjegja i vrenjtur.

— Si në maqinë.

- Pse u gdhive në maqinë, ç'hall të zuri?
- U ktheva vonë dhe... hoteli ishte mbyllur.
- Ashtu ë?.. Hajde të ulemi!
- S'ka gjë, mirë jemi dhe më këmbë.
- Atëhere, paske fjetur rehat mbrëmë!

Mora kafen dhe u ula në një tryezë. Pas pak erdhi dhe ai e më vuri përpara një gotë konjak.

- Po këtë ç'e deshe?

— Ta pish ti.

- Unë? Nuk e kam pirë ndonjëherë në mëngjez.

— Epo s'ka gjë, e ke pirë ndonjëherë në darkë, njësoj éshtë.

— Jo. Janë dy soje: në darkë shkoj në shtrat, kurse tani do të shkoj në maqinë. Kam tetëdhjetë kilometra pér të bërë sot.

— Më fal, shoku shofer i rregullt, — më tha ai duke më shikuar nën vetulla dhe e afroi gotën pér vete, po unë e ndalova.

— Atë nuk do ta pish! Do t'ja kthesht prapë banakierit, ndryshe do të ta derdh!

— C'ke kështu xhanëm, që je ngritur me xhinde sot.

— Ç'kam ë? Hëm... si duket u dashkan mbledhje të veçanta, që të kuptohemi bashkë, pasi bisedat shoqërore nuk të bëjnë efekt ty?

— Po pse, more vëlla, ç'ka ngjarë? — më pyeti ai krejt si i pafajshëm.

— Ku e ke maqinën? — e pyeta i nxehur.

— Në agjenci, të ngarkuar.

— Pér ku?

— Pér në Durrës.

— Si duket, para se të fillosh një udhëtim të gjatë, duhet të kthesht tri gota fërnet?!

— Jo ore, për nder, kjo është e dyta — m'u përgjegj ai me buzën në gaz, prandaj dhe unë ja ktheva me të kea:

— Nuk ke turp... kaq i ri dhe po merr rrugën e njé pijaneci. Mos kujton se të punosh larg ndërmarrjes sate, larg rregullit të disiplinës kolektive, (ne kishim gjashtë muaj që punonim tranzit në ajë qytet të jugut) mund të bësh si të të dojë qejfi? Nuk ke faj ti, jo... — i thashë tërë nerva dhe u ngrita nga tryzea. Kur ju afroam maqinave, ai më hodhi duart në qafë dhe ja filloj me të tijat.

— Nuk të shoh dot me xhinde, më fal, ore, për nder, në më pafsh më me gotë në dorë, të më peshtysh. Më fal, shoku «kapiten» (kështu më quante ai, qysh ditën që bëmë udhëtimin e parë me maqinë, ngaqë unë i tërhoqa vërejtjen për shpejtësi). E keqja ishte se dhe unë nuk e mbaja dot gjatë inatin ndaj tij...

Manoli u nis para meje. Në të dalë të qytetit, u ndal dhe mori një vajzë që mbante në dorë një çantë të zezë.

Ndërsa pranë kabinës sime u gjendën dy burra me një nuse të re dhe një ushtar.

— Shoku shofer, më merr deri në Lushnjë, të lutem? — më tha njëri nga burrat.

— Shofer, deri në Vlorë, po deshe. — më foli ushtari me zë të lartë.

— Nuk shkoj, jam për Elbasan.

— Po mirë, deri te kthesa e Lushnjës, se më mbaron leja sot.

— Hajde, ushtar!

## II

Zakorisht Manoli ecte shpejt, kurse atë ditë nuk po i kalonte të tridhjëte e pesat.

Pasi kaluam kthesat e Urës Vajgurore dhe dolëm në rrugë të drejtë, maqina e tij filloi të bënte zigzage nga një anë e rrugës në tjetrën. Në trup më shkuau mornica. «Ç'të ketë ky?» — mendova me vete. Shkela pedalinën e gazit dhe ju afrova përtta tejkaluar, po ai nuk ma hapi rrugën, nxori pak kokën nga kabina dhe i dha maqinës shpejtësinë maksimale.

Atëherë e kuptova se nuk kishte ndonjë defekt, por si dukej diçka ngatërronte me atë vajzën e re...

Nuk pata kohë të mendoja më tepër përkëtë, pasi ushtari më ndërpren:

— Ç'pati ai që përkak shkoi në kanal, mo usta?

— Nuk e di. për nder, ndoshta ndonjë blokim timoni...

Tek varrezat e Lushnjës, ku rruga kthehet përnë Fier, maqina e parë frenoi dhe vajza me çantë të zezë u hodh menjëherë në tokë duke përplasur derën e kabinës.

— Këtu do të zgres unë, shofer, — më tha ushtari dhe më preku lehtë në sup, pasi e pa që unë nuk e kisha mendjen.

E ndalova maqinën përpëra vajzës dhe zbrita si përtë kontrolluar një herë nivelin e vajit.

Ushtari doli përpëra maqinës dhe më zgjati dorën, duke më falenderuar, po përkak më rrëmbeu me vete, ngaqë u tërroq përt'i liruar vendin një

autobusi që ndaloi në drejtim të Fierit.

Në kohën që po shtrëngojë fijet e distributorit, që prapa dëgjova zérin e vajzës, që, pa e vënë re, ishte afrouar pas meje:

— Më falni një minutë, shofer!

— Urdhëroni, — ju përgjegja unë, duke nxjerrë kokën nga kofanua e motorit, që e kisha ngrihet në tako.

— E njihni këtë shoferin, që kaloi para jush?

— pyeti ajo, duke shikuar targën e madhe të karrocerisë sime.

— Po, e njoft, në një ndërmarrje punojmë.

— Ashtu? Keni tjetër maskara të tillë në ndërmarrjen tuaj? — pyeti ajo, që dukej sikur sytë po i lëshonin shkëndija.

Nuk besoj se do të më kishte rënduar më shumë kofanua, po të më zinte kokën, në buzët e radiatorit. E humba një çast, sikur të isha unë ai maskarai i zënë në çark. Pastaj e pyeta në tym:

— Përse e keni fjalën, ju lutem?

— Për atë aventurierin, që kaloi para jush dhe me të cilin jeni në një ndërmarrje, — m'u përgjegj ajo prerë dhe duke u dhënë fjalëve të fundit një ton ironik.

Nuk dija ç'të bëja, m'u bë një lëmsh në grykë, sikur do të më zinte frymën. M'u duk sikur një mjegull më mbuloi sytë, dhe unë nëpër të shikoja një herë aventurierin, që ishte dhe shoku im, një herë motrën time, pastaj përsëri vajzën me çantën e zezë që qëndronte më këmbë pranë meje.

— Më falni, moj motër por...

— Si e quajnë atë, ju lutem? — më ndërpren vajza duke hapur zinxhirin e çantës.

— Manol Rezi, parku automobilistik... — ju përgjegja unë, kurse ajo e mbajti shënim me një stilolaps të kuq dhe shtoi:

— Besoj se ka ardhur koha t'u tregoni vendin tipave të tillë, që duan të mbulojnë me turp profesionin tuaj.

Këto fjalë ajo m'i tha shumë e qetë, sikur të m'i thoshte motra ime, prandaj m'u duk se më rënduan më shumë...

Pasi kalova qytetin, e lëshova maqinën përparrë, me shpejtësi. Akrepi i kilometrazhit kaloi gjash-tëdhjetë e pesë, shtatëdhjetë dhe shënoi shtatë-dhjetë e pesë km. në orë; sytë i kisha fiksuar në shiritin e zi të xhadesë, që poshtë turirit të maqinës. Duart i kisha të sigurta, kurse në shpirt ndjenja një bosh-llék të thellë. Për herë të parë m'u neverit aq shumë shoku im, sa i bëra vetes këtë pyetje: — përsë më duhet një shok i tillë? Sa dëshirë kisha ta zija në rrugë. Nuk e dija se ç'do të bëja, por për një gjë isha i bindur, se ai do të ishte çasti që do të më ndante për gjithmonë me të. Po kjo nuk ndodhi, pasi Manolin nuk e talkova deri në Rrogozhinë, ku mora kthesën e Elbasanit. Pas tri ditësh u ktheva në park për t'i bërë shërbimet e nevojshme maqinës. Në kapanonin e brigadës ishte dhe maqina e Manolit. Të nesërmen, aty nga ora dhjetë, qendra e zërit njoftoi punonjësit për një mbledhje të jashtëzakonshme, në orën katër pasdite.

\* \* \*

Mbledhja filloi pa ndonjë ceremoni. Në presidium zunë vend katër punëtorë, sekretari i partisë

dhe kryetari i komitetit profesional. «Provokuam këtë mbledhje të organizatës pér të diskutuar gjetin e ulët të një punëtori tonë», — tha kryetari i komitetit profesional dhe nga xhepi i xhaketës nxori një letër, që e hapi dhe e lexoi:

«Drejtorisë së ndërmarrjes... pér kolektivin...

Më vjen keq, që kjo letër bën fjalë pér sjelljen e ulët të një pjesëtari të kolektivit tuaj. Unë kam lexuar në shtyp e kam dëgjuar pér sukseset tuaja dhe jam e bindur se gjesti, pér të cilin bën fjalë kjo letër, nuk e errëson dot punën tuaj revolucionare, por sado pak ju turpëron. Prandaj unë po ju shkruaj.

Në sallën e madhe të këndit të kuq ra një heshtje e rëndë. Të gjithë po prisnin si në ankth...

«... Rastësish, udhëtova me një shofer tuajin nga Berati në Lushnjë. Qysh në fillim më bëri përshtypje jo të mirë sjellja e tij. Unë nuk i vura rëndësi, qëndrova gjakftohtë. Mirëpo ai vazhdoi më tej.

— Do të silleni si njeri e të shikoni punën apo të hidhem — i thashë dhe hapa portën e maqinës, të cilës ai i shtoi shpejtësinë. Qëndrimi im e ndaloi. Shikojeni vetë këtë gjest shokë... Unë jam mësuese në katundin Metar. Unë dhe njerëzit tanë bëjmë çmos që të edukojmë sa më mirë brezin e ri, në mënyrë që të jetë sa më i mirë e i ndërgjegjshëm, që të mos ketë më të tillë tipa si shofer Manol Rezi.

Salla u elektrizua, fytyrat lëviznin sa në një anë në tjetrën pér të gjetur Manolin, që rrinte si i habitur andej nga qoshja e sallës.

— Kjo është, more shokë, tani si mendoni ju?

— Me leje, — e ngriti zérin një shofer i gjatë, nga fundi i sallës.

— Urdhéro, folë!

— Jooo... unë them të na flasë një herë ky shoku, që akuzohet. Ku di unë, more vëlla, ne e njohim për shofer të mirë Nolin.

— Po, po, po, të flasë vetë! — u përgjegjën zërat.

Nga qoshja e sallës u ngrit Manoli, që mundohej të tregohej i qetë, ndërsa fytyra e kuqe e tradhëtonte.

— Ajo letra nuk është e vërtetë, shokë, unë kam dy vjet këtu dhe nuk më është ndjerë zëri për keq. Me planin jam mirë... maqinën e kam mbajtur si jo më mirë...

— Mirë, mirë, këto i dimë, dhe ne të kemi vlerësuar. Tani është fjala për një gabim të rëndë tëndin, për këtë folna, — ndërhyri sekretari i partisë.

— Po, po, ja për atë do... flas, shoku sekretar. Unë nuk kam bërë asnje gjë nga ato që thotë letra. Unë zgjata një herë dorën përparrë saj, për të mbyllur derën që e kishte lënë hapur, dhe ajo si duket e ka marrë për keq...

— E pooo, kjo bën vaki, more vëlla, — tha një shofer aty pranë tij, duke shikuar si me habi shokët. Ky i dha kurajë Manolit për të vazhduar si i pafajshëm.

— ... Kështu ka qënë, për nder, more shokë...

— Me leje, more shokë të presidiumit; po pu-shoni, more shokë, një herë të flasim!

— Urdhéro, Dyl, folë, mbani qetësi, shokë! — e ngriti zérin kryetari.

— Unë them, se kjo punë duket si shumë e

ngatërruar. Në goftë se e ka bërë këtë gjest, Manoli duhet kritikuar rëndë, po.. si të them unë?.. Sikur të mos jetë ashtu, ne e marrim në qafë kot shokun.

— Jo, shok, nuk është qëndrim ky. «Dashke ta marrësh më qafë ti! Dashke ta kritikosh rëndë.» Mos harro se ti je kritikuar për vete për këto gjëra. Para se të flasësh përpara kolektivit, vëri gishtin kokës! — ndërhyri i nxehur një tornitor.

— Shoku Remzi, prit, të lutem, lëre të mbarojë një herë fjalën, — ja priti dikush nga mesi i sallës.

— Po nuk është diskutim ky, more vëlla. Këtu bëhet fjalë për një gjest që na turpëron të gjithë. Kurse Dyl Sabriu na i lustron gjérat, — tha tornitori dhe u ul tërë millef.

— Edhe unë jam dakort me këtë shokun parafolës, — e mori fjalën një shofer tjeter. — këtu nuk ka vend për diskutim me hamendje. Letra që i ka ardhur kolektivit ka adresën e plotë të dërguesit. S'ka asnjë arësyte për të dyshuar. Ne kemi një detyrë të lartë karshi popullit. Dhe në skajin më të largët të atdheut maqina shpie bukën, dritën dhe kulturën. Por ka tipa të veçantë që, me gjeste kaq të ulta, i japin detyrës sonë një nam të keq. Unë mendoj që Manolit t'i hiqet e drejta e profesionit për një vit dhe të kalojë në brigadën e investimeve.

Salla filloj të ziente si koshere bletësh. Disa aprovonin me kokë duke bërë shenjë nga presidiumi, disa të tjerë bisedonin me njëri-tjetrin. Aty nga rreshti i parë një pompiste e ngriti zërin:

— Ashtu të bëhet! Shoku Shaqir diskutoi drejt...

— Avash ti, moj shoqe, mos e merrni nxituar

të shkretën, — ndërhyri një i repartit të kovaçhanës.

— Unë them që të flasë edhe një herë Manoli. Të tregojë të vërtetën dhe... ta shikojmë më mirë...

— Unë ju thashë një herë, shokë... pér nder, ajo është keqkuptuar. Unë... gjykon i vetë, ju të gjithë më njihni... — u përgjegj Manoli.

Ai ishte i sigurt se nuk kishte dëshmi tjetër pér fajin e tij veç asaj letre, prandaj po mashtronte me hipokrizi shokët... Ndodh që në natyrën e njeriut grumbullohen, qoftë edhe instinktivisht, shumë të këqia. Secila nga këto e shëmton njeriun, por më tepër nga të tjerat e shëmton atë gënjeshtra e ndërgjegjshme. Pikërisht ajo me të cilën Manoli mundohej t'i shpëtonte përgjegjësisë.

Kjo më shtoi neverinë pér atë njeri, që kishte qenë pér mjaft kohë shoku im. Ne bashkë kishim po atë profesion, pér të cilin patëm ëndërruar qysh në bankat e shkollës. Vitet e fundit e kishim shtuar shoqërinë, po ja, kjo shoqëri doli para një prove të rëndë. Unë e doja shumë Manolin, prandaj dhe s'kisha ditur t'i luftoja sa duhet gabimet e tij, që nxorën veshët atje në jug, larg kolektivit dhe familjeve tona.

Ai ishte nga ata tipa me një natyrë të theksuar aktive dhe që veprojnë në emër të ndjenjave të çastit e jo të arësyes. Këta tipa gabojnë lehtë, edhe Manoli gabonte. Unë i flisja shpesh, por jo me këmbëngulje dhe me ashpërsi, siç duhen goditur qysh në fillim gabimet e shokut, po me butësi «se mos i thyeja zemrën», në emër të asaj dashurie shoqërore, që ngandonjëherë të vret...

Dhe tani që ai kishte shkelur në dërrasë të kalbur, unë e ndjeja veten ngushtë...

— Si të veproj — mendoja me vete. — Të ngrihem t'ua tregoj shokëve të vërtetën? — Atëhere... ai nuk do të vijë nesër me mua. Unë do të nisem me një tjeter në jug. Ktheva kokën dhe i hodha shokut të fëmijërisë një shikim vjedhurazi. Ai rrinte me kokën mënjanë dhe duart po i shtrëngonte me njëra-tjetrën sikur diçka kishte vënë midis tyre për ta dërmuar... Përsëri më erdhi keq, por në çast arësyja më pëshpëriti fjalët e autores së letrës: «Besoj se ka ardhur koha t'u tregoni vendin tipave të tillë, që duan të mbulojnë me turp profesionin tuaj». Ngrita dorën për të marrë fjalën.

— Urdhëro, shok, folë: Pa dëgjoni, ju lutem. se ky duhet ta dijë më mirë, pasi ka punuar bashkë me Manolin — tha kryetari i komitetit.

— Unë mendoj se... në raste të tillë ne duhet të mbajmë qëndrim të drejtë. Letra që u lexua është e vërtetë. Manoli është plotësisht fajtor.

Në sallë ra një qetësi e thellë. Ndonjë shofer shikonte shokun tjeter pranë si me habi, ngaqë unë, shoku më i ngushtë i Nolit, po flisja keq për të.

— Po, shokë, kështu është. Unë nuk mund ta harroj pyetjen që më bëri vajza që ka shkruar atë letër. «Keni tjeter maskara të tillë atje në ndërmarrjen tuaj?» — më tha ajo.

Këto fjalë ranë si bombë në sallë, prandaj një shok nga presidiumi u ngrit dhe vendosi qetësinë. Kurse unë vazhdova:

— Këtu kam gabim dhe unë, shokë, me gjithse i kam folur shpeshherë, për ndonjë sjellje të pahiqshme gjatë gjashtë muajve atje në jug, ai nuk u

vuri rëndësi fjalëve të mia. Shkurt, unë nuk munda ta ndreq. Por, këtë që nuk bëra dot unë, s'ka dyshim që do ta bëni ju. Ai duhet ta ndjejë thellë gabimin e tij dhe të ngrihet e të dënojë veten përpara ko-lektivit, — përfundova unë, duke hedhur sytë nga fundi i sallës, ku Manoli kishte marrë kokën në duar, sikur ta kishin zënë një palë ethe të forta...

## MYSAFIRJA

Pjetër Oshtima kishte vendosur të zbriste deri në qytet atë ditë, prandaj u rrua dhe u gatit shpejt pér udhë. Kur doli në oborrin e vogël e të rrethuar me thupra, dëgjoi një zë, që i thirri nga mbrapa shtëpisë.

— O Pjetër Oshtima!

— Hajde byjrëm! — ju përgjegj sipas zakonit. Në qoshen e shtëpisë u duk Martini, një bashkëfshatar i tij.

— A ti qenke, Martin, a? Hajde mrena!

— Jo, jo falemnderës, nuk po vij se jam pér rrugë, por kalova këndej me të lajmërue se të kërkojnë në kryesi.

— Në kryesi the, a? E c'ka më duen sot në kryesi?

— Nuk di gja, por duhet të nisesh qysh tanë, se të presin në zyrë kryetari dhe sekretari i partisë...

Xha Pjetri u nis me hapa të rëndë pér në zyrat e kryesisë së kooperativës, ndërsa me vete mendonte: «Përse të më duen vallë? Sot asht e dielë! Njerëzit janë shpërnda pér ndonjë hall të tyne... helbete, ditë pazari... Pse kjo ngutje, xhanëm?»

Një zë tjetër i brendshëm e qetësonte: «Mos

e vraj mendjen kot, or Pjetër, ndonjë punë kooperative do të jetë... Po... pse nuk e kanë lanë për nesër?.. Diçka ka këtu...».

Për të larguar këto mendime, ai e nxori kutinë dhe e drodhi një herë, por më kot. Një tjetër mendim dhe më i fortë filloi ta ngacmonte: Po sikur të kenë ndonjë gja për atë?.. Me siguri... por... po që ashtu, unë prapë do të kundërshtoj. Hee... kanë gjetë ku të falen».

1

Pranë Gurit të Cubavet, ku rrjedh një burimi i ftohtë, xha Pjetri ka ndërtuar shtëpinë e re. Pak më tej është një kasolle e vjetër ku edhe gurët e murit janë nxirë, kurse kashta vende-vende është dërmuar është i ka rënë fare. Ajo ka qënë banesa e hershme e familjes Oshtima.

Xha Pjetri i ka rrrokuillisur të pesëdhjetat, por ka ende trup të fortë. Kur ka qenë i ri, tregojnë se nuk linte dy gurë bashkë. Një herë zihej me bajraktarin e vendit, një herë mbërthehej me cubat, që, në ato kohë nuk linin gjë pa vjedhur, një herë tjetër shkelte ligjet... E, kështu që rininë e tij e kishte kaluar më tepër komit në male se sa në atë kasollen e errët, ku jetonin prindërit e tij.

Xha Pjetri ka qenë edhe në burg, pasi një herë e kishte shkelur fare, duke rrahirur një xhandar në pazarin e Milotit... Denbabaden në kasollen e Oshtimave mbretëroi shtypja dhe varfëria. Por koha rođhi pa u ndalur, si ujët e burimit malor dhe solli me vete ndryshime të mëdha.

Pas çlirimbit të vendit, xha Pjetri ishte ndër të parët, që u ndihmua nga reforma agrare. Prandaj, dhe kur u bë thirrja për bashkimin e katundit në kooperativë, ai e dha fjalën qysh në fillim. Bile u fliste dhe atyre që ngurronin.

«Hajdeni, bre burra, të bashkohemi në kooperativë. Ne deri dje kena punue tokat e bajraktarit, vetëm kjo parti na dha tokën tonë».

Pas një viti në kooperativë, xha Pjetri mbaroi së ndërtuari dhe shtëpinë e re, që e kishte filluar prej kohësh. Atëhere kush e mbante! Ishte bërë dhe një herë djalë i ri. Herë punonte me qe, herë me bagëti, herë në kanalet kulluese, që kishin filluar të kryqëzonin parcelat e bashkuara në luginën e thellë që ndante fshatin përmes. Kudo ishte me të parët. Mirëpo me gjithë këto, në atë shtëpinë e re, ende e reja nuk ishte futur me gjithë freskinë e saj!

Pjetri ka katër fëmijë, tre djem dhe Djellën, fëmijën e parë, që i ka mbushur të tetëmbëdhjetat. Djella është një vajzë e hedhur dhe e zgjuar. Ka një trup të zhdërvjellët, që e dallon nga shoqet e saj. Para nëntë vjetësh, në fshatin e saj u hap për herë të parë shkolla dhe ajo shkoi në klasën e parë. Dita e parë e shkollës, kur trembëdhjetë vocrrakët malësorë prisin si në ankth ardhjen e mësueses në klasë, është kujtimi më i bukur për Djellën. Atëhere ajo mësoi se, kur futej mësuesja në klasë, duhej ngritur më këmbë; duhej ardhur në shkollë me thonj të prerë e me rrobat e pastra. Malësorja e vogël ishte çuditur me mësuesen, me atë fustanin e saj të shkurtër me pala, me flokët e shkurtër rrëth qafës dhe me ato këpucët gri me nië lloj pushi...

Kur mësuesja ishte ulur në karrige me këmbët zbuluar, Djella i kishte pëshpëritur shoqes së saj të bangës: «Mari!.. Shif moj qyqe!.. si s'ka turp ajo që i mban kërcinjtë përjashta!»

Vitet kaluan dhe Djella kaloi nga një klasë në tjetrën me nota gjithmonë më të mira. Edhe mendimet e ngatërruara të fëmijërissë u sqaruan. Ajo i donte shumë mësueset e saj. E çdo ditë e më tepër i pëlqente edhe veshja e tyre qytetare.

Në klasën e shtatë Djella ishte nxënëse e shkëlqyer, madje dhe kujdestare e klasës. Prandaj edhe mësuesja e matematikës, Vera, e donte shumë dhe e mbante gjithmonë pranë.

Kur Djella mbaroi klasën e shtatë, i doli bursa të vazhdonte më tej. Të shkonte në qytet dhe të bë-hej mami e fshatit të saj. Ky qe një gëzim i veçantë jo vetëm për ata, por edhe për mësuesen, që kishte bërë çmos për emancipimin e malësores së zgjuar. Mirëpo për fat të keq gëzimi qe i shkurtër, pasi xha Pjetri, i ati i Djellës, nuk e pa të udhës atë punë. Me gjithë këmbënguljen e këshillit të fshatit dhe ndërhyrjen e mësueses Vera, Pjetër Oshtima nuk u tund nga e tija.

«Jo, or ti, për qìell e për tokë, nuk e lej gocën unë me më dalë prej shpije. Nuk koritet Pjetër Oshtima në pleqni, or ti!»

Kështu nguli këmbë ai dhe kështu u bë.

Djella ja shfaqi së ëmës dëshirën, megjithëse ishte vështirë të priste prej saj, që ajo t'ja ndryshonte mendjen babait. Qysh se e mbante mend veten, Djellës nuk i kujtohej që fjala e «tatës», siç i thoshte ajo babait, të ishte bërë ndonjëherë dy.

Një mbrëmje që Djella kishte shkuar në dhomën

e mësueses, pranë së cilës gjente ngushëllim, ajo i pati thënë: «Unë jam gati të të ndihmoj, Djella.. Eja të të shpie në shkollë... mos e pyet fare babanë..

Një ditë ai do të zbutet dhe do ta kuptojë.. Malësorja e kishte dëgjuar mësuesen me vëmëndje dhe pasi ishte menduar për një çast, i ishte përgjegjur me lot në sy: «Jo, mësuese... këtë.. nuk e bëj dot. Nuk e ka bërë akoma as edhe një djalë. E... si ta bëj unë?! Gjithë katundi do të flasë me qesëndi, se vajza e filanit u aratis, iku pa pyetur prindërit e saj... Babai nuk mund ta durojë këtë turp...».

Kështu që në shtëpinë e Pjetër Oshtimës ra qetësia dhe nuk diskutohej më për fatin e Djellës. Malësorja e re e ndrydhi në shpirt dëshirën e saj të zjarrtë si një ëndërr të dhimbshme.

\* \* \*

Në zyrën e kryesisë së kooperativës xha Pjetri gjeti kryetarin dhe sekretarin e partisë me dy vajza të panjohura.

— Mirë se erdhe, Pjetër Oshtima, — i tha kryetari duke i shtrënguar dorën me gjallëri.

— Mirë se ju gjej, shoku kryetar, — ju përgjegj xha Pjetri si i hutuar. Pastaj i shtrëngoi dorën sekretarit të partisë dhe dy vajzave të panjohura.

«Hej, si më priten, gjithë gaz!.. Diç do të ketë këtu!.. Po këto të dyja? ç'janë këto mysafire?.. Pse të kenë ardhë? Hej... e... më shofin me dashamirësi... e di, e di, moj lule, që do të më kërkoni Djellën time për ndonji shkollë. Por... do t'ju përcjell dhe unë urtë e butë...».

Këto mendime përtypte me vete xha Pjetri,

duke përfituar nga koha që të tre burrat dridhnin nga një cigare, ashtu siç ndodh shpesh, para fillimit të ndonjë bisede.

Pasi tymosën cigaret, sekretari e hapi bisedën i pari:

— Po si je, or Pjetër Oshtima, si i ke ata fëmijë?

— Mirë, shoku Faik, falemnderës, po ti si i ke?

— Mirë, mirë, rriten... Po... Si duket je pre-gatitur për pazar sot, ë?

— Poo, ashtu... desha me dalë një herë, — ju përgjegj xha Pjetri duke u munduar të tregohej i qetë.

— Shumë mirë, të shkosh që ç'ke me të, — i tha sekretari që, pasi ngjiti me majën e gjuhës letrën e cigares që ju hap, vazhdoi: Ne pak punë kemi, po mbarojmë shpejt. Dhe... ja si është puna, Pjetër. Këto dy gocat na kanë ardhur për ndihmë ose të themi me të rejat, për eksperiencë në kooperativën tonë. Do të punojnë e jetojnë bashkë me ne nja dy vjet. Kjo është nga Korça, — vazhdoi sekretari duke treguar me kokë një vajzë me trup të shkurtër e të shëndoshë dhe me flokë gështenjë e të dendur, që i derdheshin rrëth qafës. — Kurse kjo tjetra është nga fshatrat e Gjirokastrës. Këto duan që të ndahen në dy shtëpi të fshatit për të banuar, me qëllim që të njihen sa më afër me jetën e njerëzve tanë. Kështu pra, për këtë të thirrëm dhe ty, nëse mund ta marrësh njëren në shtëpinë tënde?

Xha Pjetri, që i kishte dëgjuar me kujdes të madh fjalët e sekretarit, u gjallërua menjëherë dhe u përgjegj duke lëvizur nga karrigeja:

— Posi, bre burra? ! Jo njana, por tē dyja tē vijnë, pasha zoten. Po këto janë gocat tonë, mor shoku sekretar, na paskan ardhë prej tosknie! Bre, bre!

Tē dy vajzat, që kishin pritur me kureshtje se si do tē zhvillohej biseda me fshatarin e panjohur, u gjallëruan menjëherë nga fjalët e tij tē ngrrohta e tē singerta. Njëra prej tyre, ajo korçarja, që dukej si më e hedhur, ndërhyri menjëherë:

— Ju falemnderit shumë, xhaxha, ne e dinim se do tē gjenim tek ju dashurinë e prindërve tanë dhe bujarinë e malësorit.

Xha Pjetri e dëgjoi në heshtje dhe me sytë gjysmë tē mbyllur korçaren, ndërsa me vete mendonte:

«He, more hej... brisk qenka nga goja... a thue ta marr këtë në shtëpi teme?... ë?... Rrezik ta mësojë edhe Djellën pas vedit, atëhere do tē kérkojë dhe ajo me shkue në Korçë. Jo, jo... Ma mirë po marr këtë gjinokastriten... duket se asht vajzë e urtë».

— Po mirë, mor shoku kryetar, meqë këto dashkan me u nda, atëhere le tē vijë njana në shtëpinë time. Ja... le tē vijë kjo që rri pak si e turpnueme. Në shtëpinë e xha Pjetrit kjo do tē jetë si në shtëpinë e saj. Kështu?... A po don me ardhë në shtëpinë teme, moj bijë? — e pyeti ai gjirokastriten duke e shikuar me dashuri.

— Falemnderit, xhaxha, me gjithë qejf do tē vij, — u përgjegj vajza e kënaqr.

Në mbrëmje në shtëpinë e Pjetër Oshtimës kishte një gjallëri të veçantë. Tre djemtë e tij kishin rrethuar mysafiren dhe dëgjonin tërë sy e veshë tregimet për fëmijët e kooperativës së saj të largët.

I zoti i shtëpisë ishte ulur këmbëkryq në një postiqe, në anë të oxhakut dhe me ata sytë e picërruar e të futur thellë në gropëzat e tyre shikonte herë plakën e tij, që preqatiste darkën me Djellën dhe herë mysafiren e re me tre djemtë e gëzuar.

«Hej, hej... çfarë kohe erdhi! Dikur nuk luent dot burri nga fshati i tij, kurse sot ngrihen djem e vajza nga jugu në veri nga veriu në jugë. Po mirë xhanëm djemtë, por këto gocat si i lenë prindërit? ! Hej, mor Pjetër, pse bahesh budall? Po këto punë i ban partia, or bacë, ajo e di se si asht e mira».

Këto mendime përtyppte xha Pjetri, duke lëshuar shtëllunga tymi përpara mustaqeve të dendura.

Edhe mysafirja nuk rinte mënjanuar, përkundrazi, ajo shikonte me kujdes çdo gjë e çdo lëvizje. Ajo e kuptoi menjëherë se në atë shtëpi, ndonëse të re, nuk kishte zënë vend ende jeta e re. Ajo nuk pa aty tryezën e karriget, apo dollapin e ushqimeve dhe rregullin e brendshëm që kishte atje, në shtëpinë e saj. Mysafirja shikonte me interesim të veçantë shoqen e saj të ardhme, Djellën. Atë vajzë me tipare të bukurë, e shëndoshë që, e mbësh-tjellë me disa metra pëlhirë të bardhë, qepur palapala deri në fund të këmbëve, i dukej si një grua

e moshuar. Fustani i saj, nëse mund ta quante ash-tu, e çuditi shumë mysafiren...

Xha Pjetri, pasi shkundi çibukun në parvazin e vatrës, u mbështet pas murit dhe u foli fëmijëve me një ton urdhëruesh:

— Lejeni rehat, mor dreqën, mysafiren, se po ja merrni frymën fare, — pastaj ju drejtua asaj:

— Mirë thonë për ne pleqtë se, bashkë me pleqninë, na rrjedhin dhe mendtë. Kemi dy sahat që po rrimë, dhe unë nuk të kam pyetë ende për emnin.

Mysafirja, e kënaqur nga kjo ndërhyrje e të zotit të shtëpisë, ju përgjegj menjëherë:

— Persefoni, më quajnë, xha Pjetër!

— Sii... Personi the, a? — pyeti xha Pjetri, duke rrudhur pak fytyrën.

— Jo... Persefoni, — ju përgjegj ajo me bu-zën në gaz, e me një çehre të kuqe në fytyrë.

— Aha... Përsafoni, ë? Mirë. Mirë. Të ngatë-ruem e paske emnin, por do ta mësojmë me kohë.

— Mua nuk më vjen keq, mund të më flisni si të doni, qoftë dhe me ndonjë emër që t'ju pël-qejë juve.

— A thue përnjimend, a? — pyeti me shaka i zoti i shtëpisë.

— Urdhëro, xha Pjetër? — Këtë herë ishte Persefoni, që nuk e kuptoi dialektin e xha Pjetrit.

— Të pyet nëse e ke me gjithë mend, — ndër-hyri Deda i vogël, që shkonte në klasën e pestë. Atëhere mysafirja dhe i zoti i shtëpisë qeshën me gjithë zemër e, bashkë me ta, qeshën dhe Djella me nënën e saj, që ndërkokë e preqatitën darkën.

Djella hante bukë shumë ngadalë dhe e men-

duar. Shpesh ja hidhte vjedhurazi sytë mysafires së largët dhe shikonte me kujdes çdo gjë të sajën. I pëlqente ata flokë të zez e të dredhur, që me ballin e bukur formonin ca unaza të vogla, vetullat e gjata, dy sytë që shkëlqenin si të lotuar dhe mjekrën e rrumbullakët me një gropë në mes.

Kështu që filloj të shikonte dhe veten e saj me sytë e mendjes dhe të bënte ndonjë krahasim, ashtu siç bëjnë vajzat shpesh kur shikojnë njëratjetërën me sy kritik...

Edhe Djella kishte flokë të dallgëzuar e vetulla të zeza, por pak më të shkurtëra. Edhe ajo ishte e bukur, kishte trup të mirë, por ajo bukuri nuk dukej nga ato tesha të rënda e të bardha, që për dy ditë bëheshin për t'u larë. Këtë gjë Djella e dinte mirë, se jo një herë ja kishte thënë dhe mësuesja e saj, Vera...

Saherë që ndeshte në shikimin e mysafires, Djella i ulte sytë dhe skuqeji në fytyrë. Ajo e ndjen te se mysafires nuk i pëlqente gjendja në shtëpinë e saj...

Pas buke, Persefoni u mat të ndihmonte Djellën, me qëllim që të mbaronin punët shpejt dhe të uleshin, të bënин pak muhabet. Mirëpo i zoti i shtëpisë nuk e pa të udhës...

— Mos na korrit, moj bijë, ti s'ke ardhë hala dhe don me na ba punët e shtëpisë?! I rregullon vetë ajo, atë punë ka.

— Nuk ka ndonjë të keqe, xha Pjetër, unë jam mësuar që të mos rri pa punë. Prandaj, po të më lini të punoj bashkë me Djellën, do ta ndjej veten si në shtëpinë time.

— Po mirë, moj gocë, të punosh pos. Por son-

te të kemi mysafire, dhe zakonet tona nuk na lejojnë që të futim në punë mysafirin, — ju përgjegj i zoti i shtëpisë prerë dhe duke shikuar të bijën me bisht të syrit...

Pasi u ulën rreth zjarrit të gjithë, mysafirja filloj t'u tregonte për fshatin e saj, për familjen dhe fatin e saj në të kaluarën. Kur ajo përmendi se i jati punonte kuzhinier në mensën e kooperativës, xha Pjetri pyeti kureshtar:

— Po kush ha në atë mensë?

— Kushdo, xha Pjetër, anëtarë të kooperativës, traktoristë dhe njerëz që vijnë me punë shtetërore nga qyteti. Ne i kemi të gjitha, edhe furrën e bukës, edhe çerdhen e fëmijëve, edhe infermierinë.

— Po ju qenkeni si në qytet!

— Edhe këtu tek ju do të bëhen të gjitha.

— Eh... Këtu tek ne është vështirë, moj goce, po të paktën të bahet ajo furra e bukës,

— Jo, xha Pjetër, edhe këtu do të bëhen patjetër. Sot na tha sekretari i partisë, se shpejt do të fillojë ndërtimi i furrës së bukës.

— Po pra, po, na e kanë thanë atë dhe do të bahet, po... për ato të tjerat asht e vështirë. Ee... kush do të kujdeset për çerdhen, apo për atë «fermerinë» këtu tek ne?

— Kush do të kujdeset?.. Po ju vetë, gratë dhe vajzat e fshatit. Ja, për shembull Djella juaj pas një viti në shkollë, mund të bëhet një infermieri shumë e mirë. (Aha, këtu e pat puna. Xha Pjetri lëvizi nga vendi, sikur dikush të kishte harruar një gjilpërë në postiqen poshtë tij).

Djella uli kokën dhe po shikonte me vëmendje

çorapen, që kishte në dorë, gjoja se ju ngatërrua peri, po veshët ama i mbante përpjetë. Edhe nëna e Djellës u zu ngushtë dhe po rrinte si e hutuar. Të shoqit nuk ja kishte thënë askush ato fjalë, aq hapur, në sytë e vajzës.

Heshtjen që krijoj biseda e mysafires e prishi zëri i trashë i të zotit të shtëpisë.

— Jo, jo, moj goce. Djella nuk asht mësue me dalë prej shpie. Nuk ka lindë kjo pér asi punësh. Pas një viti do të lirohet i fejuemi prej ushtrie dhe do ta martojmë. Ai le të bajë çka të dojë. Sot zanati i Djellës asht me ruejtë nderin e shpisë së Oshtimajve... Këndej kena do zakone të tjera ne.

Persefoni e pa se mendimi i saj krijoj një atmosferë të nderë, sidomos kur në atë dhomë të vogël e pa tavan kumbuan fjalët e prera të Xha Pjetrit. Prandaj, ajo ndërroi takt pér të gjetur kohën e përshtatshme, megjithëse fjalët e tij të fundit i rënduan në sedër...

— Joo... më fal, xha Pjetër, më duket se ma more pér keq. Unë e zura vetëm si shembull, me që ra fjala, se fatin e Djellës e dini ju më mirë se unë... — Këto fjalë sikur e qetësuan disi plakun, por heshtja tregonte se atmosfera ishte akoma e elektrizuar.

Mysafirja e humbi një çast, prandaj, pér tu treguar indiferente nga ato që ndodhën, mori në dorë çorapen që punonte Djella dhe po e shikonte në dritën e zbetë të llambës.

«Hëm... goca që e zgjodhe si pér të urtë kjo, ë?... He, more Pjetër, ç'e fute vetë ujët nën rrogaz, or bacë».

Kështu mendonte xha Pjetri duke dredhur

një cigare të trashë me ato gishtërinj të ashpër e tërë kallo. Në kohën që u zgjat të merrte ndonjë urë, në anën tjetër të zjarrit, Persefoni, që ndiqte me bisht të syrit lëvizjen e tij, rrëmbeu një thëngjill të ndezur dhe ja afroi te cigarja. Ai jepte e merrte me bulçitë, kurse ajo e përpiu me një shikim të mprehtë atë fytyrë të ashpër, me nofulla të forta e ballin e gjerë, që e pëershkonin kanale rrudhash. Ky portret i gjallë, që plotësohej nga një palë mustaqe të ashpra e të dendura, e shpuri Persefonin thellë viteve, në jetën e errët të fshatarit tonë, në botën e tij të brendshme. Ju kujtan Persefonit fjalët e sekretarit të parë të rrethit, në takimin me aksionistët e së resë, në kooperativ malore.

### 3

Ndonëse xha Pjetri nuk kishte qejf që vajza e tij, Djella, të flinte me Persefonin, s'kishte sesi ta kundërshtonte dëshirën e mysafires. Prandaj u uroi natën e mirë dy vajzave të reja dhe u fut në dhomën e tij të gjumit.

Dhoma e miqve, siç i thoshin të zotët e shtëpisë, nuk kishte ndonjë ndryshim nga dhoma tjetër, vetëm se ishte më e pastër dhe e shtruar më mirë.

Nga dritarja e vogël, hëna kishte dërguar në faqen e murit një rreze drite. Persefoni ju afrua dritares dhe e hapi. Një erë e lehtë ja freskoi faqet dhe e bëri të ndjente një rrëqethje në trup. Nata ishte e getë, dëgjohej vetëm ndonjë e lehur qeni. Në qiellin e kthjellët shkëlqenin yjet pambarim. Kur

Persefoni ngriti sytë drejt hënës, që po i afrohej buzës së malit Vinjar, pa dashje mendja u nis për në fshatin e saj të largët. Në ekranin e ndriçuar të hënës ajo filloi të shikonte me sytë e mendjes atë dokumentar të thjeshtë, por të bukur e të pa-harruar të jetës saj: pjesëmarrjen në ndërtimin e kanalit Bistricë-Vagalat, kursin 6-mujor të rinisë, detyrën e vështirë të sekretares së rinisë në kooperativën e bashkuar. Pastaj atë ditë, më të gjëzuarën e jetës së saj, kur në mes duartrokositjesh, atje në sallën e kulturës, ajo u pranua kandidate e partisë. Kur u fut në kujtimet e ditëve të fundit, që, bashkë me shumë shokë e shoqe u nisën nga Gjirokastra për të sjellë në veri, në kooperativat e reja malore, eksperiencën pesëmbëdhjetëvjeçare të kooperativës së tyre, zëri i malësores e shkëputi nga ato përfytyrime të bukura.

— Ç'bën aty, Foni? Eja të biem, se i shtrova teshat.

— Eh... sa mirë më the, ja kështu të më flasësh gjithmonë, Foni kështu më flasin edhe atje, në fshatin tim.

— Edhe unë kështu kam qejf të të quaj — ju përgjegj Djella e kënaqur, që rastësisht ja gjeti zemrën mysafires.

Persefoni, pasi i hodhi një shikim hënës, sikur t'i thoshte: «natën e mirë» e mbylli dritaren dhe shkoi e u shtria në vendin e saj pranë Djellës.

Përreth poçit të llambës, që me zor ndriçonte atë dhomë të madhe, filloi të vërtitej një flutur e vogël në ngjyrë të hirit.

— Ti e ke mbaruar shtatëvjeçaren?

— Po!

— Në qoftë se babai nuk do të të kishte ndaluar, sot do të ishe në vitin e dytë për mami, apo jo? — e pyeti papritur Persefoni.

— Pse, ku e di ti këtë? — tha Djella e cuditur.

— E mësova sot nga sekretari i partisë, — ju përgjegj shoqja me buzë në gaz e duke shikuar me kujdes.

— Eh... ashtu është, — tha Djella me gjysmë zëri edhe i uli sytë si të ishte vetë fajtore për qëndrimin e babait...

— A do të shkoje tani në ndonjë shkollë, nëse do të të kërkxonin?

— Si mund të shkoj, kur babai nuk do, a e dëgjove se si të tha ty, kur ja kujtove?

— Po ti vetë, a ke dëshirë të bëhesh mami?

— Po, Foni, kam, bile zanati i mamisë më pëlqen shumë, por kush më pyet mua se. Sa herë takohem me Verën, unë i flas gjithmonë për shkollën, që më ka mbetur merak dhe ajo më jep kurajë: «Mos u mërzit, vetëm këtë dëshirë nxitjua dhe Dranes, Maries dhe Files, (që janë shoqet e mia të klasës) se shpejt do të vijë dita, që dhe prindërit tuaj të binden».

— Kush është kjo Vera? — pyeti Persefoni me kureshtje.

— Është mësuesja jonë e klasës së shtatë, eh, sa e mirë që është! Do të njihesh me të. Pardje kur e takova, më tha që flitet se do të ndërrohet veshja e rëndë e fshatit, po nuk di nëse është e vërtetë.

Persefoni ndjente kënaqësi të veçantë, për faktin që bashkëfolësja e saj ishte e heshtur dhe e

mbyllur vetëm atje, para të atit. Prandaj, s'ju ndejt pa ja shprehur atë kënaqësi.

— Kur të pashë në fillim, mendova se do të ishe një vajzë e humbur nga ligjet e kanunit, po ti qenke e mrekullueshme, Djella!.. Po ato shoqet që ke patur në klasë, a kanë dëshirë për të mësuar?..

— Këtu ka shumë goca, që i ka zgjuar shkolla shtatëvjeçare, por kanë frikën e prindërve, — ju përgjegj ajo me zë të druajtur, sikur dikush ta ruante pas dere.

— Hee... Frikës i ka ardhur fundi, Djella edhe tek ne kështu ishte më parë. Kurse sot prindërit tanë çuditen se si para pesëmbëdhjetë vjetëve kanë patur mendime aq të shtrembëra. Mësuese Vera të ka thënë të vërtefën. Këto ditë do të mblidhen të rejat e të rinxjtë, e dy fshatrave fqinjë, për të diskutuar zëvendësimirë e veshjes së rëndë me tesha të reja, më të lehta e më higjenike. Kjo është një punë që partia na e ngarkon neve, të rinxje, ta bëjmë në fillim. Kurse xha Pjetri e të gjithë të vjetërit shpejt do të mësohen me këtë të vërtetë të kohës së re.

Djella kishte mbështetur faqen në dorën e majtë, që e kishte ngritur bërryl mbi jastëk dhe dëgjonte me èndje mysafiren e re.

Sa shumë gjëra mësoi Djella atë natë! Shoqja e re i foli për kooperativën e saj të largët, për vështirësitë e para dhe sukseset e mëvonshme, i foli për grupin artistik të kooperativës, për Gjirokastrën dhe heronjtë e heroinat e saj.

— A thua se të gjitha ato që janë bërë në fshatin tuaj do të bëhen shpejt edhe në kooperati-

vën tonë, Foni? — e pyeti malësorja tërë kureshtje shoqen nga fusha e Gjirokastrës.

— Për këtë as mos ki dyshim, Djella. Qëllimi më i lartë i partisë është që atdheu ynë të zbulurohet kudo njësoj.

Pastaj mysfirja vazhdoi tregimin për hollësitë e udhëtimit nga fshati i saj në atë të Djellës. Djella herë dëgjonte me vëmendje e herë binte në mendime: «Edhe kjo vajzë si unë është, por... ka ardhur nga ana e anës, pa ndonjë njeri të shtëpisë me vete... Sa larg i ka lënë prindërit e saj! E... këtu flet pa drojtje, si ndonjë djalë! Po unë?.. hëm, nuk jam e zonja të shkoj në shkollë, në një qytet pesë orë larg fshatit tim. Ka të drejtë mësuese Vera që më thotë frikacake». Këto mendime i lëndonin plagën, i kujtonin shkollën dhe me mend fillonte ta shikonte veten në bankat e shkollës, me bluzën e bardhë, atje në qytet, ku ajo kishte shkuar vetëm tri herë. Mësuese Vera i kishte folur nxënëses së saj të zgjuar për shumë vajza punëtore, kooperativiste, brigadiere e aktiviste të dalluara, po ajo nuk kishte njohur ndonjë. Kurse tani prej kaq kohësh ajo kishte pranë vetes, në punë e në shtëpi, një vajzë të tillë. Ky fakt jo vetëm i nxiste dashuri për shoqërinë e re, por dhe forca për të qëndruar më këmbë pranë saj. Rreth dy vajzave nga jugu, që punonin në fushë me pantallona, u lëshuan fjalët, thashethemet e grave e plakave nga njëra anë dhe përkrahja e mbrojtja e vajzave dhe djemve të rinj nga ana tjetër.

«Si s'kanë turp, janë bërë tamam si çuna. Pa le kur flasin para burrave, para pleqve të fshatit pa ju skuqur faqja. Bubu, mos goftë thënë!»

«Turp mund tē jetē pēr ne, qē punojmē me një qerre tesha nē shpinë e nē mbledhjet e fshatit rrimë si kërcunj. Turp nuk éshtë tē thuash atë qē mendon».

«Pushoni ju e mblidhni mendtë, se shumë po i ndiqni pas».

Zjarrit tē kohës së re, qē kishte ndezur partia nē fshatin malor, dy vajzat e ardhura nga larg i hodhën dru tē thata, e flaka e tij u ngrit më lart.

E vjetra me tē renë grindeshin nē fushë, nē rrugë, nē burim e nē shtëpi. Ditët kalonin, dhe e reja bënte gjithmonë një hap më shumë. Dy vullnetaret kalonin nga një shtëpi nē tjetrën, e nisën hapët luftën ndaj koncepteve tē vjetëruara. Në shtëpinë e Pjetër Oshtimës u prish qetësia. Dhoma ku flinin Persefoni dhe Djella e ndërrroi pamjen. Në dritare pēr herë tē parë zunë vend perdet, nē qoshe tē dhomës me ndihmën e tē rinjve, dy shoqet ngriten një minder tē gjerë, qē shërbente dhe pēr krevat. Pranë tij një tryezë e vogël, e mbi tē disa libra. Kjo dhomë u bë jo vetëm si bazë, ku shpesh hynin e dilnin tē rejt, por edhe si model. Pjetër Oshtima ra nē hall; shoqëria e ngushtë e së bijës me «mysafiren» nisi ta shqetësonte. Prandaj mbrëmjeve, kur mysafirja bëhej shkaktare e ndonjë diskutimi, ai nuk ja mbante më hatrin. Grindej me tē deri nē fund, derisa mbetej ngushtë para arësyetimit tē saj. Në këto diskutime nisi tē futej dhe Djella. Ndodhi, qē si papritur ajo tē dalë pērballë tē atit. Pēr herë tē parë ajo kuptoi se, nē mes saj dhe tē atit nuk kishte ndonjë lumë tē pakalueshëm qē tē përpin, por se duhej vetëm guxim ta kaloje atë. Gardhi i Pjetrit nisi tē çuhej,

e ai nuk dinte si t'i mbyllte shtigjet e reja. «Le të dalë ku të dalë. Kështu erdhën kohërat» — e ngushëllonte ai nganjëherë veten.

Dita që në fshat u punua thirrja e partisë për heqjen e teshave të rënda dhe për thellimin e mëtejshëm të së drejtës së gruas e gjeti Djellën të fortë e të guximshme. Ajo u ngrit e para dhe përkrahu atë thirrje. Pjetër Oshtima dridhte një duhan aty nga fundi i sallës së mbledhjes. Gjatë e drodhi atë cigare, ishte hutuar? Nuk i ngjitej letra? Apo donte të hiqej sikur po merrej me një punë dhe të mos i shihte sytë që i ishin drejtar, kur vajza e tij u bënte thirrje gjithë shoqeve për të ecur rrugës së re të partisë?

Ngjarjet u rrokullisën. E reja me të vjetrën përfyteshin kudo. E para më e fortë, e një hap më tej, e dyta më e lodhur e kërkonte të prehej. Lindi dhe kërkesa për një mami-infermiere. Dhe kjo çështje u diskutua me të gjithë në mbledhje. U propozua Djella. Pjetër Oshtima nuk drodhi duhan këtë radhë. Ai u ngrit e kundërshtoi: «Nuk mund të shkojë... ne jemi pak krahë pune... ajo duhet të mendojë për vete...» Të tjerët u ngriten kundër. Mali Vinjar nuk lëvizti, pasi malet nuk luajnë, por Pjetrit ashtu ju duk, sikur mali Vinjar kishte ardhur e ishte afruar atje, pranë dritares së mbledhjes e bënte sehir...

## N J O L L A T

U hap dera dhe një erë e ftohtë vërvshoi në sallë. Bashkë me erën u fut një djalë i gjatë me trup të mbushur, me një kasketë gri në kokë. Pasi kërkoi një çast me sy nëpër sallë, çau mes çiftesh me hapa të ngadalshëm dhe ju afrua Anilës.

— Kapelja në fuqi, shok! — i tha me një buzë-qeshje të shtirur kavalierit me të cilin kërcente Anila dhe i vuri kasketën në kokë.

Kavalieri ja la damën. Anila shtangu një çast, pastaj foli e habitur, ndërsa sytë nisën t'i qeshnin.

— Razi! Ti këtu?

— Po... siç e shikon, jam unë, bile shumë afër. Thashë të vij një herë të marr pak nga gjëzimi i ditëlindjes suaj — ju përgjegj ai me ton ironik!

— A mund të kërcejmë bashkë?

Pas një rrrotullimi të gjatë u gjendën pranë portës. Aty ndaluan vallëzimin, kavalieri e mori damën për dore dhe dolën nga salla.

Atë natë Adriatiku dukej shumë i zemëruar, dallgët e shkumëzuara i përplaste pas bregut, si të kërkonte vend për t'u shtrirë më tej. Koha ishte e kthjellët. Era e ftohtë, që frynte nga perëndimi, fshikullonte plevat që lëshonin një rënkim të the-

llë. Aty buzë detit, pranë një vile, kishte ndalur çifti që doli nga salla e vallëzimit.

— Më fal, se të prisha dëfrimin, por nuk do të të mbaj shumë — tha ai.

— Ç'ke kështu, Razi? Ç'ka ndodhur?.. Si erdhe?.. Kur?..

— A, nuk e prisje! ? — ja preu ai fjalën — e po, ja që erdha. Erdha të të uroj për ditëlindjen, nuk e dija se ishe kaq e zënë.

Anila u hutua, në shpirt ndjeu një ngacmim të çuditshëm, pastaj një rrëqethje nga të ftohtit. Ngriti jakën e xhaketës, u mbështoll dhe ju afroa më shumë atij.

— Të lutem, më thuaj, ç'ka ndodhur? Pse nuk...

— Nuk besoja që miqtë e tu të lejonin të të merrte kaq lehtë nga salla një i panjohur — e ndërpreu ai.

— Nuk ka gjë për të çuditur. Këtu ne jemi shumë vetë. Akoma nuk njihemë të gjithë me njëri-tjetrin, pastaj këtu nuk ka kusarë vajzash...

— Ha, ha, ha — qeshi ai me ironi të hidhur.

— E po s'ka pse të ketë të tillë, kur mund t'i marrin ato haptaz. — Razi! — i foli ajo dhe i hodhi duart në sup, u tulit pranë tij aq sa në trupin e saj ndjeu frymën shumë të njobur për të.  
— Më thuaj, të lutem ç'ke kështu?

Ai mbeti për një çast si dru plepi me të cilin luan era. Por shpejt e mblodhi; e largoi vajzën dhe i tha me ton të zvarur:

— Kujtovë se jam larg dhe nuk marr vesh se ç'bëhet? Je gabuar, nuk më paske njobur, si duket.

— Të lutem mos më mundo kot! Më thuaj ç'ka bërë vaki? Çfarë paske marrë vesh?

— Ato që bën ti këtu — ja ktheu ai nervoz.

— Nuk kisha faj unë që nuk doja të vije në kurs.

Ti m'u lute dhe unë «hajde të mos ta prish qejfin»

— theksoi ai me ironi — kurse ti më shkrihesh këtu në vallëzime, në xhiro buzës së detit, natën bredh nga të do qejfi.

Këto fjalë e goditën vajzën në sedër, prandaj ja ktheu me guxim:

— Nuk është e vërtetë... Ç'janë këto akuza... Ku i ke gjetur?... Unë nuk bredh, përkundrazi, shkoj me të gjithë mirë, të gjithë më duan e më respektojnë.

— Ashtu?... E po natyrisht, për një xhiro buzë detit me një bukuroshe të tillë... Kërkon të më hedhësh hi syve? S'ke turp!

— Turp? Jo, jo, turp duhet të të vijë ty, që paske humbur arësyen, të paskan xhindosur shpifjet.

— Sii? Paskam humbur arësyen, mbylle gjën — foli ai nervoz dhe i lëshoi përparrë një letër të mbledhur shuk. — Na merre këtë të të mbushet mendja se nuk më hedh dot hi syve... Nuk dua të të shoh më fytyrën...

Pas këtyre ai u largua me hapa të gjatë buzë detit. Anila mbeti e shtangur, me një goditje të thellë në shpirt. U përkul, gjeti letrën përparrë këmbëve mbi rërën e lagur, hodhi pastaj vështrimin nga ai dhe nuk e duroi dot dhëmbjen.

— Razi — i foli, por zërin e saj të dridhur e mori era dhe e përzjeu me fërshëllimën e plepave, kurse ai humbi tej në mes të vilave, si hije.

\* \* \*

Nga salla e leksioneve vërshonin në hapësirë tingujt e orkestrës. Anila ju afroa konviktit me hapa të ngadalshëm, menduar, me një boshllék të madh në shpirt. Ndërsa shokët dhe shoqet e saj gjëzonin atje në sallë, gjëzimi i Anilës u tret në errësirën e natës me zhurmën e detit, pas atij që iku. Mendoi një herë të futej në sallë, por prapë ndërroi mendim. Ngjiti shkallët e konviktit e, sapo doli në drithë, hapi menjëherë letërën e zhubrosur dhe lexoi:

-- Razi!

Si gjithmonë dhe këtë herë po bëhem mbarë për të shkruar unë, më i vogli. Qysh ditën që kundërshtova dashurinë tënde me Anilën, ti më ke ndenjur larg, bile s'më ke folur fare. Nuk ka gjë... Natyrisht nuk është e lehtë të prishesh me një shok, bashkë me të cilin je rritur. Por... ç'të bësh kur shokut ja ka prishur mendjen një vajzë, që pa u kujtar për «të dashurin» e saj shkrihet në vallëzime; në shëtitje buzë detit, bile edhe në orët e vona. I pëlqejnë dhe filmat, veçanërisht kur vendin e Raziut e zë ndonjë «shok». Që të mos bie në gjynah, edhe emrin tënd e kujton ndonjëherë. Mos ki asnë merak për të, të bukurën e kanë të gjithë në kujdes...

Me sinqeritet  
Të fala M.....

«C'është kjo?» — mërmëriti Anila me vete dhe padashur e mbështolli letërën me dorë. Me hapa të shpejtë u fut në dhomë dhe u lëshua mbi kreva-

tin e saj. E hapi prapë letrën e zhubrosur dhe nisi ta lexonte sërisht. «Ç'janë këto poshtërsi, kush i ka shkruar... Kush është ky M., mos është Medari?.. Si ka mundësi të ketë shkruar ai përmua!?.»

Pasi u mundua një copë herë për të gjetur kuptimi e initialit «M» mendimet u nisën pas atij, që e la të vetme në buzë të detit.

«Pse iku kaq shpejt?.. Pse nuk duroi të m'i thoshte këto me gojë? Kaq shpejt ju trondit dashuria përmua? Ku shkoi? Ku do të jetë në këtë natë të ftohtë?.. Ç'pyet për të, moj budallaqe? Ai nuk pyet për ty. Por a ka faj ai, a mund të revoltohet aq shumë një njeri që nuk të dø? Jo, jo... ai më do, nga dashuria përmua ai vuan. Po unë ç'faj kam?..»

Kjo pyetje i kujtoi Anilës akuzat e letrës. Mesytë e mendjes vështroi krejt jetën e saj gjatë tre muajve, në kurs. «Jo, njëmijë herë jo, nuk ka asnjë arësy, kjo është shpifje, të kanë mashtruar, Razi» — foli ajo me lot në sy dhe me zërin nervoz, sikur në dhomën e heshtur të ishte futur hija e atij, që u largua në errësirën e natës.

Anila dhe Raziu ishin dashruar një vit më parë, në një fshat malor. Ajo kishte shkuan si mami vullnetarisht për dy vjet në fshat, kurse Raziu si elektriçist për të shpënë dritën, po atje. Dashuria e tyre lindi në mes malesh, në mes përpjekjesh për të zbukuruar jetën e njerëzve. Ajo e donte Raziuun me atë dashuri, që mund ta shprehë vetëm një zemër e singertë; ashtu e donte dhe ai atë.

«Ç'e do elektriçistin? Ti je mami e me shkollë të mesme, nesër mund të vazhdosh studimet dhe

do të bëhesh doktoreshë, e pse...» — i thoshin asaj.

— «Ç'të duhet mamia ty ehu, sa doktora ka rrëth vetes ajo, aq të mira paç ti. Merr ore ndonjë punëtore, kokëunjur, a ndonjë fshatare të ta dijë pér nder» — i thoshin atij kur u hapën fjalët e para pér fejesë.

Këto mendonte Anila. Ajo po kalonte në mendje me ngadalë tërë shiritin e kujtimeve të dashurisë së saj. Sa ndodhi të bukura kishte aty? Ato i jepnin forca, por ja: ngjarje e fundit; ndarje, dhembje, vetmi, kurse poshtë nga salsa e leksioneve vinte si e mbytur melodia e vallëzimit.

«Si do t'i bëhet? — mendoi ajo — eh, sa keq që e mira krijohet me aq mundim dhe rrëzohet me dy fjalë. Jo!.. Nuk është e mundur, kjo nuk durohet, nuk mund të lihet kështu...»

Ajo e kishte njohur natyrën e rrëmbyer e xhe-loze të Raziut, po nuk e priste të arrinte deri aty...»

Të nesërmen Anila nuk e fsheu dot mërzinë. E pyeti Liria, shoqja e saj më e afërt dhe ajo i tregoi shkurt. E pyeti dhe Medari në minutat e pushtimit:

— Ç'ke sot, Anila, nuk të shoh mirë.

Ajo e shikoi drejt në sy dhe u mundua se mos zbulonte diçka në vështrimin e tij. «Nuk e di ti... me të vërtetë nuk di gjë? Nuk je ti autori i letrës, i këtij hidhërimi?» — mendoi ajo. Anila nuk dalloi gjë në sytë e tij, por megjithatë ju përgjegj me thumb:

— Si?.. Kujtova se do ta dije mirë arësyen.

Këto fjalë e habitën Medarin.

— Nuk të kuptoj, përsë e ke fjalën?

— Nuk kupton? Çudi! Mua më duket se nuk  
është vëشتirë pér ta kuptuar.

— Anila, tē lutem më thuaj drejt, ku e ke  
fjalën?

Singeriteti i shokut tē klasës e hutoi Anilën,  
megjithatë ajo kishte vendosur ta shpinte deri në  
fund bisedën. Letra kishte në fund gërmën e parë  
tē emrit tē tij. Ajo e dinte se Medari kishte patur  
prej kohësh shoqëri me Raziun, pra rruga më e  
drejtë pér tē zgjidhur atë nyje do tē ishte vetëm kjo.

— Unë nuk dua tē hakmerrem, Medar — nisi  
ajo — por dua vetëm tē më thuash: pse ke folur  
**aq keq pér mua** dhe t'i **përgënjeshtrosh** shpifjet.

— Unë kam folur?... Cfarë?... Paskam shpi-  
fur? E kujt, kështu?

— Raziut.

— Kur kështu? — pyeti ai i habitur.

— Tashti, kohët e fundit — ju përgjegj ajo.

— Nuk është e vërtetë. Gjashtë muaj më pa-  
rë, kur ai do tē fejohej **me ty**, unë si shok i tij nuk  
doja. Dhe kjo nga që ty nuk tē njihja mirë. Por  
rasti e dha që ne tē vijmë bashkë në këtë kurs.  
Tre muaj janë tē mjaftueshëm tē njihesh me sho-  
kun, apo shoqen e klasës. Këtu tē njoha: ti je nxë-  
nësja më e mirë e paralelit, nga tē gjitha vajzat.  
Të gjithë tē respektojnë. Unë me sa di tē kam  
qëndruar afër; tē kam konsideruar si motrën time.  
Deri më sot ne nuk kemi patur asnjë keqkuptim  
midis nesh. Janë tē vërteta këto?

— Po, janë... Kështu është.

— Po atëhere përsë m'i ke bërë këto akuza?

Edhe unë kam tē drejtë tē fyhem.

— Po si tē veproj unë, Medar? Ja, merre kë-

të lexoje, qëndro në vendin tim dhe gjej fajtorin,  
— i tha ajo e hutuar duke i zgjatur letrën.

Ai e mori letrën dhe e lexoi me kujdes deri  
në fund.

— Ç'është kjo — pyeti i habitur.

— Unë nuk e di prandaj po të pyes ty — ju  
përgjegj ajo.

— Unë nuk di asgjë, kjo është marrëzi. Nuk  
marr vesh ku e gjete këtë?

— Raziu e solli mbrëmë.

— Raziu? Mbrëmë?

— Po, po, mbrëmë, kur ti ishe në qytet.

— Unë nuk di asgjë, Anila. Kjo është posh-  
tersi e bërë në emrin tim — i tha ai me nervozizëm.

— Të lutem mos u ndiz! Unë nga kjo letër  
jam prishur me Raziu. Mbrëmë ai më tha fjalët  
e fundit dhe u largua. Nuk e di, ndoshta ke të  
drejtë, por vetëm me fjalë, kjo letër nuk hidhet  
poshtë.

— Po ti shiko, moj, ky nuk është shkrimi im,  
të betohem Anila, kjo është intrigë.

\* \* \*

Atë mbasdite Medari nuk shkoi në teatër si  
gjithë të tjerët. Letra e Anilës i kishte sjellë shqetësim  
të madh. Sapo u larguan shokët, u fut në  
klasë, nxori letrën nga xhepi, e hapi mbi bankë  
dhe nisi ta shikonte me kujdes. U ngrit e nisi të  
ecte me hapa të ngadalshëm në rrugicën që ndante  
klasën në mes.

«Kush mund ta ketë shkruar?.. Me cilin shkon  
keq Anila? Po unë?... Letra ka një të vërtetë

nga mendimet e mia, po kush i di këto përvëç meje dhe Raziut? Kujtime, copëza bisedash, përfytyrime kalojnë njëra pas tjetrës në mendjen e shqetësuar të Medarit, dhe ja një shkëndijë: aty nga fundi i muajit të parë të kursit, kur Anilën e zgjodhën kujdestare të klasës, Medari i kishte treguar shokut të bankës historinë e dashurisë së saj. I kishte folur për shokun e tij të fëmijërisë, Raziun edhe për mendimin e gabuar të Anilës. Kaluan ditët dhe Anila kishte ecur gjithmonë përpëra. Po ashtu dhe Medari u bë një nga nxënësit më të mirë, kurse Ramizi, shoku i tij i bankës, mori një rrugë tjetër. Nuk mësonte, shëtiste nga i donte qejfi, bile largohej edhe nga shkolla «sipas nevojave të tij». U kujdes për të Medari, por ai nuk pyeti për ndihmën e shokut. U kujdesua Anila, kujdestarja e klasës, dhe klasa e tërë. Ramizi përfitonte nga metoda e bindjes, e edukimit. Ai e dinte mirë këtë, dhe kur fliste ndonjë shok, ai thoshte: «Ç'do të më bëjnë, do të më këshillojnë, do të më bindin, do të ecim. Të rrojë metoda e bindjes».

Këto ju kujtuan sërisht Medarit. Ju kujtua dhembledhja e fundit: Ramizi ishte larguar katër ditë pa leje nga kursi. Kjo revoltoi jo vetëm grupin e tij, por gjithë paralelin «A». «Veç qëndrimit të kolektivit unë mendoj të njoftohet dhe ndërmarrja nga e cila ka ardhur Ramizi» — kishte propozuar Anila. «Po, po, bile mendoj që, në qoftë se Ramizi nuk do të ndryshojë rrugë, t'i shkruhet nga ana e shkollës dhe një letër familjes së tij» — ishte hedhur Medari. Ramizi kishte folur kundër dy shokëve, se gjoja e kishin inat e ja bënин me

qëllim». Po mendimi i gjerë i gjithë masës i hodhi poshtë fjalët e tij. Ramizi pranoi përsëri fajet, por Anilën dhe Medarin nuk i shihte dot. Ai nuk ishte në gjendje të kuptonte ndihmën e tyre të singertë. Ai nuk vlerësonte rolin e klasës, prandaj i dukej sikur vetëm Anila dhe Medari e vërenin dhe nxirnin në shesh gabimet që bënte. Përfytyrimi i këtyre ndodhive i ngjalli dyshime Medarit. Ky filloï të mendonte: «A thua ta ketë shkruar Ramizi një letër të tillë?.. Ku dreqin i ka shkuar mendja kaq larg? Kaq shumë të na urrejë, mua dhe Anilën. Kësaj i thonë: bëj mirë, të gjesh keq. Po sì mund ta vërtetoj këtë gjë? Ai me siguri nuk mund ta pranojë kurrë një akuzë të tillë. Gjarpëri di t'i fshehë këmbët.»

Një rreze mendimi hapi një rrugë të re: Medari mori letrën dhe u lëshua te banka e fundit. Futi duart në sirtar dhe nxori që andej një fletore të trashë, e hapi në faqen e parë. Shënime të çrregullta për një temë politike, zhgaravina dhe një shtyllë e ngatërruar llogarish. Medari shtriu letrën pranë fletores dhe nisi të krahasonte shkrimet me kujdes. Kontrolloi rreshta, fjali, fjalë të njëjtë dhe përfundoi se shkrimi ishte i njëllotë. Vetëm se ai i letrës ishte shkruar pak pjerrët. «Ky është... ky e ka shkruar... s'ka dyshim» — mendoi ai dhe doli nga klasa.

\* \* \*

Megjithëse ishte vonë, Raziut nuk i bënte zemra të gdhihej atë natë në qytetin e huaj, prandaj doli në buzë të xhadesë. Pasi priti një copë

herë gjeti maqinë dhe u nis për në qytetin e tij.

Ashtu siç na ndodh shpesh, kur një brengë na e mundon shpirtin dhe s'kemi me kë flasim, Raziu nisi të mendonte: «Pse nuk prita të paktën të takoj Medarin?.. Ndoshta u solla keq pa të drejtë me Anilën?.. Jo, jo!.. A nuk e gjeta duke vallëzuar ashtu siç thuhej dhe në letrën e Medarit?..» Përpëra xhamit të maqinës nisën të vërtiteshin si në një ekran të zbetë kujtimet e dashurisë së tij, atje në një fshat të largët.

Shoferi i maqinës ishte djalë i ri dhe tip i hedhur e kureshtar prej natyre. Kështu që pas ndonjë copë rruge e pyeti pasagjerin e heshtur:

— Ç'ke kështu, shok, mos je gjë sëmurë?

— Jo, jo nuk kam gjë — ju përgjegj prerë Raziu i zgjuar nga mendimet. Përsëri heshtje. Maqina çante nëpër natë, ndërsa shoferi, që nisi të mërzitezj nga heshtja e shokut të udhës, tha:

— E paske një hall më duket.

— E po njerëz jemi dhe hallet për ne janë — ja ktheu Raziu me buzë në gaz.

— Ashtu, ashtu, po të them të drejtën, kur të pashë në rrugë u gëzova që gjeta shok për udhëtim. E kam bezdi udhëtimin vetëm — ja ktheu shoferi me fytyrë të qeshur dhe i zgjati paqetën.

Ky gjest e ngrohu Raziun, e largoi nga mendimet dhe në kabinën e maqinës solli ngrohtësinë e një shoku. Shpirti i shqetësuar është gjithmonë i ndjeshëm, vetëm pak kujdes e dashamirësi duhet për ta bërë të shpërthejë sinqeritetin e tij. U desh dhe një ngacmim kureshtar i shoferit që Raziu të niste të hapte zemrën: Kur nuk ke shokun, pyet shkopin — thotë një fjalë e popullit. Por Raziu e

gjeti një shok dhe, ndërsa akrepi i kilometrazhit luante me numrin tridhjetë, ai i tregoi shoferit brengën e tij.

— Po mirë, kështu u largove ti, pa u sqaruar me të? — pyeti shoferi i pakënaqur.

— Po.

— Cudi! Ti duhej të bisedoje me Anilën, me shokët e saj. Bile po të qe nevoja dhe me drejtuesit e shkollës së aktivistëve. Si u bëka puna kështu! Një letër dhe hop, të gjitha t'i flakim?... Jo... më fal, po kështu si ke vepruar ti është për të qeshur.

— Unë mendoj se s'ka gjë për të qeshur, po ta provosh në veten tënde.

— Si, or vëlla, s'ka gjë për të qeshur — ja ktheu shoferi — po pse kështu mbrohet dashuria e krijuar aq bukur, siç e tregove ti? Duke i besuar më tepër një letre, që mund të jetë e tërë shpifje, se sa asaj që i ke besuar zemrën? Jo, kjo është për të qeshur që ç'ke me të. Unë jam vetë i fejuar por, po të dëgjonim fjalët e thëna lart e poshtë, sidomos ne shoferët, nuk do të kishim punë tjetër veçse të ndanim nga një grua në muaj... Mos harro, burazer, se ndaj së mirës vepron gjithmonë e keqja.

Raziu e dëgjoi në heshtje shoferin. Arësyetimi i tij i singertë e zuri ngushtë, e nuk dinte ç'ti thoshte. Nisi përsëri të bluante mendimin: «ndaj së mirës vepron gjithmonë e keqja». Maqina po bënte kilometrat e fundit, ora ndante natën më dysh. Përpara shtrihej qyteti i madh e i larë në drita. Raziu u shkëput nga mendimet dhe pyeti shoferin, si të ishte shok i tij i njohur prej kësh:

— Atëhere si thua ti, ç'do të bëje po të ishe  
në vendin tim?

— Unë?.. Unë them që nesër të lësh punën.  
Merr leje dhe ktheu përsëri tek e fejuara, që me  
sa duket nuk të ka faj. Hiç mos u mendo, dëgjomë  
mua, ecë kërkoje të vërtetën, pastaj vepro — i tha  
shoferi dhe e ndaloi maqinën.

Raziu i shtëngroi dorën shokut, zbriti nga ka-  
bina dhe mori me hapa të gjatë, tutje bulevardit  
të qetë.

\* \* \*

Të nesermen, ndërsa dielli rrrokullisej në pe-  
rëndim, Raziu u fut i menduar në korridorin e qetë  
të kursit të aktivistëve.

Një vajzë flokëverdhë e me trup të hedhur,  
që kryente atë ditë detyrën e dezhurnit, e pyeti:

— Kë kërkoni, ju lutem?

— Medar Kadirin — ju përgjegj ai.

— Tani dalin nga leksioni, prisni, ju lutem  
— i tha vajza dhe i tregoi një stol. Raziu nuk u  
ul, i hodhi një sy gazetës së afishuar, pastaj ashtu  
kot, ju afrua tabelës së fletërrufeve. Shikimi i mbe-  
ti në një fletërrufe të madhe, shkruar me germa  
kapitale. Rreshtat nisën të pasonin njëri-tjetrin:  
«Ka ardhur koha që shoqëria jonë të hedhë tej  
veset e ulta shpifëse, që prishin jetën tonë dhe  
cënojnë dinjitetin e personit. E tillë është letra  
shpifëse e Ramiz Çelës kundër Anila Vanias dhe  
Medar Kadirit...»

Raziu nuk po u besonte syve, në trup ndjeu  
mornica, zemra nisi t'i rrihte më fort. Gjaku i vër-

shoi me vrull në gjithë trupin, ndërsa në shpirt ndjente një gëzim të përzier me një pendim të thellë. Vajza që kryente dezhurnin, duke parë me kureshtje në drejtëm të tij, doli jashtë dhe i ra ziles së pushimit. Raziu u lëshua përpjetë shkallëve, por pa dalë nga kthesa e katit të parë ndeshi në sytë e habitur, qortues dhe të dashur të Anilës, që po zbriste me libra në duar. Ja mori duart, e tër-hoqi pranë vetes në korridor dhe pa pyetur përsytë kureshtarë i foli: — Anila... si unë?.. Por fjalën nuk e mbaroi, pasi nga kreu i shkallëve u dëgjua zëri i trashë i Medarit:

— Oo... Kush na paska ardhur!.. Mirse na er-dhe, mor shok! Raziu ktheu kokën dhe e pa shokun si i zënë në faj.

## NË GJI TË JETËS

Qyteti i vogël S... shtrihej në një luginë të thellë mes maleve shkëmborë të ashpra e të thata. Vetëm nga lindja kishte një shpat mali të pyllëzuar me pisha. Qyteti kishte nja dy-tri punishte lokale. Pas zbulimeve gjeologjike në periferi, qyteti S... u bë i dëgjuar. U ngrit një kantier i ri ndërtimi dhe nisi puna për ndërtimin e një fabrike për pasurimin e mineralit. Pas gjashtë muajsh në kantierin tonë erdhi inxhinieri i parë. Si të tillë, punëtorët e shikonin me një farë kureshtje dhe me respekt.

Ai u vendos në një dhomë të vogël, më vete. përbri dhomës sonë. Në mëngjez ngrihej pak më vonë nga të tjerët, zbriste poshtë në klub, kthente një kafe me konjak dhe ngjitte rrugicën me kall-drëm, që të shpinte në zyrat e kantjerit. Më të rrallë dilte në objekt, ku merrte kontakt me teknikun e zbatimit dhe kthehej përsëri në zyrë.

Aty e kalonte pjesën më të madhe të kohës së punës. Mbasdite shtrihej në krevat. Në mbrëmje zbriste në sallën e bilardos, që sapo që hapur rë qytetin e vogël. Kaloi gati një muaj nga dita e ardhjes dhe ai nuk shoqërohej me njeri. Rinte

ashtu i heshtur e i vëtmuar. Të shtunën i hipte autobusit pér në Tiranë... Kuptohet se qëndrimi i tij nuk linte përshtypje të mirë te punëtorët por, meqë ishte fillimi, nuk i vunë dhe aq rëndësi. Kur binte fjala pér të, dikush e mbyllte me zemërgjërsësi: «Kushedhi si e ka hallin a derëbardhë, fundja dje erdhi nga Tirana, duhet kujdes me shkollarët, vëlla». Punëtorët e kantierit ishin vendas, e në përgjithësi të rinj. Unë e Qezari ishim të ardhur nga larg, si specialistë. Ne kishim punuar në shumë objekte të tjera. Kuptohet që kishim parë më shumë e ishim njojur dhe me inxhinierë të tjerë. **Qëndrimin e inxhinierit të ri e shikonim** me tjetër sy, prandaj dhe vendosëm që të njiheshim e të afroheshim me të. Kështu një mbrëmje i shkuam në dhomë. Ai ishte shtrirë mbi krevat dhe pinte cigare. Te këmbët e krevatit kishte lënë çizmet me baltë. Mbi komodinën pranë kokës së krevatit ishte një revistë «Ylli» e djegur me cigare në dy-trivende. Mbi të, në vend të tavllës së cigareve, ishte një kapak llamarine nga ata të kavanozëve me reçel. Në dyshemenë me dërrasa binin në sy fije shkrepshët të harxhuara, bishta cigaresh. Nga dera e dollapit prej kompensate dukej një kostum gri, që inxhinieri e vishte të shtunave, kur nisej pér në Tiranë.

— Hë?.. Ç'thotë klasa punëtore? — na tha, pasi u ngrit ndenjurazi dhe na zgjati dorën.

— Në formë të plotë sportive, inxhinier — ju përgjegj Qezari me shaka.

— Si je, inxhinier? — e pyeta unë.

— Shumë mirë, — m'u përgjegj vonuar.

— Po më çudit, inxhinier — ja ktheu Qezari, pasi u ul në stol.

— Përse? — e pyeti ai.

— Për nder, nuk e marr vesh si mund të jesh shumë mirë duke ndenjur kaq i vetmuar.

— Epo ç'të bësh, ka tipa e tipa kjo botë.

— Ashtu, ashtu, po, sidoqoftë, në këto vendet e vogla shoqëria është gjëja më e parë e më e nevojshme për ne punëtorët.

— Epo nuk thonë kot se punëtorët janë njerëz praktikë — tha inxhinieri.

— Kjo është e vërtetë, inxhinier. Bile kjo është dhe arësyjeja që punëtorëve u vjen keq kur ndonjë shok i teorisë u qëndron larg.

— Ashtu, ashtu — tha ai i zënë ngushtë, po pa e dhënë veten.

Pastaj biseda u përzje. Ai kaloi shpejt në Tiranë dhe na pyeti nëse i kishim parë ndërtimet e fundit që ishin bërë atje; nëse kishim parë ndonjë shfaqje teatri a baleti. Pasi i thamë se kishim parë, bile i shprehëm edhe mendimet tonë, ai u gjallërua e u bë më i afërt në muhabet. Kaluam nga një «kodër» në tjetrën, ashtu siç ndodh shpesh, fare pa e vënë re, nëpër biseda. Qezarit nuk ju durua dhe ja vuri në dukje inxhinierit qëndrimin e tij ndaj punëtorëve. Qezari ishte tip më vete, njeri i dashur me të gjithë, murator e montator i zoti. Për shokun nuk kursente as gjakun, por kishte dhe një zakon: të nxirrte bojën. Kur shihte të ligën te shoku, ja thoshte atë copë, pa kërkuar forma e rast të veçantë, ku të ndodhej, në rrugë, në klub a kinema, në mes të të tjerëve.

Pas ndonjë ore dolëm të tre bashkë dhe zbri-

tëm në sallën e mensës. Nga mensa u kthyem në dhomën tonë. Inxhinieri ndeji një çast më këmbë, i hodhi një sy gjithë dhomës dhe ndali mbi një raft të vogël librash. Vuri buzën në gaz, pasi ende në dérrasat me të cilat dikur ishin ambalazhuar maqineritë dhe që ne kishim sajuar «bibliotekën», lexoheshin emërtime markash të huaja:

— Paskeni dhomë të pastër ju, — tha inxhinieri.

— Epo ç'të bëjmë, inxhinier, njeriu po s'mbajti dhomën e gjumit pastër... ja pat Qezari i nxituar.

Më erdhi keq, pasi inxhinieri, me siguri do ta nuhaste aluzionin e fjalëve të shokut. Po ç't'i bëja Qezarit? Ja që ai, ashtu ishte mbrujtur.

Pas asaj nate inxhinieri nisi të shoqërohej me ne. Shkonim bashkë në kafe, në sallën e lojrade, apo në ndonjë film. Po, ç'është e vërteta, afrimi bëhej më tepër nga ana jonë. Kjo nuk na bënte përshtypje, po pér një gjë na vinte keq: Megjithëse ai nuk i kishte mbushur njëzet e katër vjetët, pinte duhan. Mëngjez nuk hante fare, e zëvendësonte atë me konjak. Një mëngjez nuk m'u durua pa ja kujtar këtë si gjë të keqe. Ai më dha të kuptoij se nuk duhet të mendoja pér ato gjëra që ai i dinte mirë. E lashë atë bisedë. Ai filloj të afrohej me punëtorët, por kjo ndodhë më tepër në klub. Rreth tij u gjendën të parët ata tipa, që ua kishte qejfi gotën e rakisë. Një mbrëmje, që inxhinieri erdhi në dhomë pér të na kthyer një libër, Qezari e ndali dhe hapi bisedën pér pijen. Inxhinieri dëgjoi në heshtje dhe, pasi e la fjalën shoku, ai ja ktheu me përtim e i pakënaqur:

— E dini atë përrallën e Nastradinit me Qosen? Pse e ngrohe, pse e ftohe? Kështu e pëscva edhe unë me ju. Në fillim ankoheshit për indiferentizmin tim, tani që unë u shkriva me punëtorët, ju më mësoni të di me kë të shoqërohem. Unë nuk jam shef kuadri, që të interesohem për karakteristikat e njerëzve.

— Megjithatë jo vetëm shefi i kuadrit interesohet për t'i njohur njerëzit rrëth tij. Unë nuk them t'i veçosh njerëzit, por t'i shohësh me sy kritik, dhe të dallosh ata që duhen edukuar, si duhen goditur veset që mund të kenë. Kush mund ta bëjë këtë më mirë se ju, inxhinier?

— Më duket se juve ju është mbushur mendja se pikërisht ju mund t'i tregoni rrugën e drejtë një inxhinieri. Bëni mirë të mësoni të silleni — e mylli ai bisedën dhe u ngrit që të dilte.

Kjo bisedë nuk solli ndonjë ndryshim në qëndrimin e inxhinierit, vetëm se hodhi një copë akull në mes tij dhe Qezarit...

\* \* \*

Drejtori i kantierit ishte njeri i shtruar, i thjeshtë, i dashur me të gjithë. Nuk kishte kryer ndonjë shkollë, por e kishte zhvilluar shkolla e jetës. Punëtorët e donin, se ai futej menjëherë nëpër ta, jetonte me hallet e tyre. Drejtori kishte dhe një huq: kur i hipnin të tijat, pesë minuta gjëmonin zyrat.

Ndërsa po shkruaja disa tabela për sigurimin teknik në zyrën bri asaj të drejtorit, zëri i tij më tërroqi vëmendjen:

— Të lutem shumë kontrolloje veten, se nuk

je në rregull! Detyra jote është në objekte e jo në zyrë, në dhomë apo në klub. Po lë përshtypje të këqia te punëtorët.

— Unë nuk do pyes oreksin e secilit këtu edhe për llogaritë e klubit, shoku drejtor.

— Jo, jo, dhe për atë do të pyesësh, jo secilin, po normat shoqërore. Ti je kuadër i lartë dhe duhet të jesh shembull.

— Epo unë nuk vij nga malet për të njohur këtu normat shoqërore, shoku drejtor.

Heshtje. Këtu mbaronte pesëminutëshi i drejtorit. Kjo ishte vetia e tij. Pas një pauze u dëgjua përsëri, por jo zëri i parë.

— Dëgjo, inxhinier: ti je djalë i ri, je afërsisht në moshën e djalit tim. Prandaj dëgjomë, qoftë dhe si prind apo si shok, si të duash. Ti ke ardhur këtu nga bankat e universitetit. Është ca vështirë te ne; unë ta thashë këtë që ditën e parë. Ç't'i bësh, ja që fabrikat na duhen, jo vetëm në qytetet e mëdha. U futëm në muajin e dytë dhe ti akoma rri larg njerëzve, larg punës. Pa mendohu. shikoje më mirë punën, afrohu me njerëzit. Duhet të mësojmë ngajeta, inxhinier.

Inxhinieri i rralloi disi vizitat në klub dhe rrinte më tepër në dhomë. Shoqëria midis meje dhe atij vinte gjithmonë duke u shtuar. Isha kurioz të njihja shpirtin e tij, arësyet pse e kishte aq të vështirë të ambientohej me jetën në qytetin e vogël. «Ndoshta ka arësyet që ne njerëzit e kantjereve nuk i kuptojmë» — mendova shpesh. Nuk u desh shumë kohë dhe shoqëria jonë mori karakter intim. Unë i tregoja ndonjë ndodhi a kujtim të jetës, jo vetëm për të ndjerë atë kënaqësi që pro-

vojmë të gjithë, por dhe për të mësuar diçka nga jeta e inxhinierit.

Inxhinier Ilia ishte fëmijë e vetme, ishte rritur e rrrethuar nga një kujdes i veçantë: atij nuk i kishte hyrë gjëmb në këmbë, siç thotë populli. E kishte parë medaljen e jetës vetëm nga ana e ndritshme, e sheshtë. Kishte njohur shtatorë të gëzuar, pushime verore, plazhe, rrugët e bukura plot dritë në kryeqytet, ku ai ishte lindur e rritur. Pra derisa filloi detyrën e inxhinierit, mbresa më e vrazhdë për të kishte qenë koha e provimeve dhe ndonjë ferrë dashurie rimore. Kështu që ardhja në qytetin tonë, thellë në malësinë e ashpër, ishte kontakti i parë i inxhinier Ilias me vështirësitë. Në qytetin tonë bënte ftohët dhe nga malet vinte shumë shi. Këtu nuk kishte ende salsa moderne shfaqjesh e as bulevarde me drita neonit. Kinemaja jo-në ishte ende një barrakë pupuliti e gjatë e pa pjetërsi. Por dhe ne kishim défrimet tona, kishim shoqërinë e çiltër të ndërtuesit dhe të minatorit. Kishim dhe ne gëzimet tona. E në këto gëzime, në ditëlindjen apo fejesën e ndonjë shoku mundoheshim të térhiqnim edhe inxhinierin.

— Ai ndoshta nuk ka zemër të keqe, por është tip i vrazhdë, megjithëse lexon mjaf libra — më thoshte inxhinieri për Qezarin. — «Nuk them se s'është djalë i mirë, po lëkura e tij e butë duhet kalitur, e kjo nuk bëhet me sentimentalizmë» — më thosh Qezari nga ana tjetër.

Një të dielë ne shkuam si kolektiv në ndihmë për elektrifikimin e një fshati tej maleve, që rrëthonin qytetin tonë. Kurse inxhinieri u nis që të shtunën për në Tiranë. Kjo e revoltoi Qezarin. Dhe

mua nuk më erdhi mirë, bile ja thashë dy ditë më parë inxhinierit mendimin tim. Ai tha se kish-te pasur një lajmthirrje dhe se e prisnin në Tiranë.

Të hënën në mbërëmje inxhinier Ilia erdhi në dhomën time për të më sjellë një libër që e kisha porositur. Qezari u nxitua dhe kërkoi rrugë për të hapur bisedën:

— Si e kalove asaj Tirane, inxhinier?

— Mirë, po ju?

— Shumë mirë.

— Gëzohem — tha inxhinieri dhe hapi një revistë si për të humbur mendjen, por Qezari shkoi më tej:

— Besoj se s'të duket çudi që mund të kalo-het shumë mirë e diela duke ngritur shtylla me krah?

Inxhinieri u skuq në fytyrë. Nuk deshi t'i përgjegjej, po si duket nuk e mbajti dot qetësinë.

— Ç'do të thuash me këtë?

— Dua të them që inxhinieri duhej të ishte dje në mes të punëtorëve, atje në elektrifikimin e fshatit.

— E çfarë, do të më tregosh tani rëndësinë e elektrifikimit, se nuk e di?

— Jo. Këtë me siguri që e di e mund të dish më shumë gjëra, po çështja qëndron në tjetër vend...

— Urdhëro, shoku murator e më trego rrugën që kam humbur, më jep eksperiencën tënde — i tha inxhinieri duke i prerë fjalën me nervozizëm.

— Me shkollë nuk di shumë gjëra, inxhinier, po dua të të them vetëm një gjë, ashtu siç e kuptoj unë. Ke dy muaj këtu dhe akoma nuk njeh as katër-pesë punëtorë me emra. Pra ky ambient me sa duket është i papërshtatshëm për ty... në

qoftë se kur vazhdoje universitetin mendoje se do të dilje inxhinier vetëm për Tiranën, këtë nuk do të ta falte shoqëria që të dha bursë.

Me sa kuptova unë, këto fjalë e goditën thellë në sedër inxhinierin. Një çast mbeti i zënë ngushtë, por prapë nuk e dha veten.

— Është e kotë të flasim bashkë, ti ke qejf vetëm të grindesh, ti s'ke respektin më të vogël për epronët e tu — tha ai dhe doli nga dhoma nervoz.

— Nuk bëre mirë, Qezar, i thashë shokut i pakënaqur.

— Pse, ç'të keqe ka? Tjetrit, më mirë thuaja hapur atë që mendon.

— Nuk është kaq lehtë të zbërthesh ndërgjegjen e tjetrit. Duhet më shumë durim dhe takt.

Prej asaj dite inxhinieri i shmangej takimit me Qezarin.

Pas tri-katër ditësh ja hapa përsëri bisedën në dhomën e tij. Inxhinier Ilian thellë në ndërgjegje e mundonin fjalët e Qezarit «në qoftë se kur vazhdoje universitetin, mendoje se do të dilje inxhinier vetëm për Tiranën...». Këtë ai tha hapët mua: «Ka të drejtë, këto fjalë nuk m'i kishte thënë njeri deri më sot... E keqja është se ne e kemi vështirë me veten tonë... Në fund të fundit, dikush duhet t'i përballojë vështirësitë e një ndërtimi të ri... Është shumë më vështirë të mësosh vetë, se sa të mësosh të tjerët. Po sidqoftë, Qezari është tip i vrazhdë.»

Të dielen pas grindjes me Qezarin, inxhinieri nuk shkoi në Tiranë. Banorët e qytetit atë ditë pyllëzuan bregun e lumit që ndante qytetin në dysh.

— Ndonjë ditë në të ardhmen do të vijmë të rrimë në hijen e plepave që mbollëm vetë — na tha inxhinieri pasi mbaruam punën vullnetare.

— Po, një ditë këtu do të gjelbërojë plepi, pranë tij do të ngrihen pallatet e bardha të qytetit të ri. Kështu ndodh kudo te ne... Asnjë vend s'ka qenë qytet i bukur vetëvetiu, duart e kanë bërë — i thashë i rrëmbyer nga një dëshirë çasti. Inxhinieri vuri buzën në gaz dhe më shkoi krahun.

Përsëri dhe të shtunën tjetër inxhinier Ilia e la Tiranën.

Në mbrëmje në sallën e këndit të kuq ishin mbledhur të gjithë punëtorët e kantierit dhe të ftuar të tjerë. Sy të gëzuar, fytyra të rreshkura, duar të ashpra nga puna, buzë të qeshura e tym duhani e kishin mbushur sallën. Në tryezën e qendrës, në mes të punëtorëve më të mirë, kishte zë-në vend xha Rexhepi, punëtori më i vjetër. Atë natë ai merrte Urdhërin e Punës të Klasit të Dytë me rastin e pesëdhjetëvjetorit të tij. Ky ishte shkaku i gëzimit. Inxhinieri iku me marifet nga tryeza e qendrës dhe erdhi pranë meje. E kthyem nga një birrë dhe u futëm në bisedë.

Një gëzim në tërë sallën na ndërpree. Përpara xha Rexhepit kishte qëndruar më këmbë e shoqja e drejtorit. E ftonte të kërcenin danc! Eh, sa në hall kishte rënë mjeshtri ynë. Veshët i ishin skuqur si ato lulet prej dylli. «Ngrehu, xha Rexhep» — i tha dikush. Të tjerët qeshnin. Ai u ngrit. Ishte porositur «*tango*» pér xha Rexhepin. Gjatë viteve të cilimit ai kishte mësuar vetëm tangon pak. U ngrit e nisi të zvarriste këmbët. Ai, xha Rexhepi, aq i gjallë, i dlirë, i shkathët e shakatar në jetën e përditshme, atje në «*tango*» dukej si

një dru lisi që e vërtisnin të tjerët. Ato duart e tij të ashpra e të regjura nga puna, që vite me radhë kishin lëvizur kushedi sa ton gurë, që kishin bërë rrugë, ura e mure, qëndronin tanë si të ngrira e të druajtura, sikur gruaja e drejtorit të ishte vezë e mos e thyenin.

«Jepi, xha Rexhep» — i tha një minator i gjatë, që me vështirësi i hidhët hapat duke kërcyer me llogaritaren e re të minierës.

— Njerëz të çuditshëm — tha inxhinieri me shikim të tretur në sallë.

— Ç'gjë të çudit? — e pyeta.

— E shikon atë gjatoshin?.. Nuk di të kërcejë fare, e megjithatë ka dalë aty dhe as që pyet nëse u pëlqen kjo ose jo të tjerëve.

— Kështu janë punëtorët, inxhinier. Kjo është çiltërsia e natyrës së tyre. Në shpirtin e tyre ruajnë jo vetëm forcë pune, por edhe dashuri për jetën, për argëtimin. Atë guxim që kanë në punë ata e kanë dhe në biseda, në këngë e në valle. Atë që ua thotë shpirti, ata e thonë copë, thjesht e pa kërkuar fjalë të bukura. Kjo është kënaqësia e tyre. E shikon gjatoshin që hidhet në tango pa e vrarë mendjen se ne të dy i bëjmë vërejtje rithmit të tij? Inxhinieri kishte ngjitur supin pas meje dhe po më ndiqte se ku do të dilja. — Ja pra, ai nesër do të futet kushedi sa metra nën tokë dhe do të çajë zemrën e shkëmbit, pa u menduar se shkëmbi mund të inatoset me të e t'i lëshohet sipër. Unë jam vetë punëtor, inxhinier, i njoh mirë ata. Nuk di, ndoshta e tepëroj, por më duket se, sa më shumë ta përziejë njeriu trupin dhe mendjen me punën, aq më i dashur bëhet për nje-

rëzit. Në të kundërt, qoftë dhe pa vetëdije, i kultivon të këqia shpirtit.

Inxhinieri kishte ulur kokën dhe rrötullonte ngadalë e i menduar gotën e birrës. Ndenji ashtu në heshtje një hop, pastaj ngriti kokën dhe me një sinqueritet që unë nuk ja kisha lexuar ndonjëherë në sytë e tij, më tha:

— Ke të drejtë, në përgjithësi ashtu është. Unë nuk kam patur deri sot ndonjë shok thjesht punëtor. Kështu është, pse ta fsheh, nuk kam patur ndonjë rast, vetëjeta ime ka qenë kështu.

Një punëtor erdhi dhe e ftoi inxhinierin në vallen e Kukësit. E lamë bisedën e dolëm në valle.

Të shtunën tjetër në mbrëmje po luanim shah në dhomë. Qezarit i kishte ardhur një lajmëthirrje nga familja dhe kishte shkuar në postë. Muzgu sapo kishte rënë mbi kantier. Jashtë shiu ja kishte marrë shtruar qysh nga orët e para të pasdites. Te porta e dhomës u gjend dezhurni i shqetësuar.

— Shoku inxhinier, themeli i korpusit kryesor u shemb!

— Si?.. Themeli?.. ku, mor, u shemb?

— Në qoshen e sipërme, aty ku sot derdhëm shtyllën e betonit.

Inxhinieri rrëmbeu mushamanë dhe u lëshua jashtë. E ndoqa pas. Në themelin e korpusit kryesor të fabrikës ishin ngritur muret mbi nivelin e tokës. Ndërsa në katër qoshet ishin ngritur shtyllat prej betonarmeje. Njëra nga këto shtylla ishte rrëzuar, toka kishte pësuar një rrëshqitje. Defekt i rëndë e i papritur. Inxhinieri u prish në fytyrë. E shikoi i heshtur një copë herë vendin, pastaj i tha dezhurnit:

— Shko lajmëro punëtorët, lajmëro menjëherë elektriçistin të na vërë prozhektorin e madh! — Dezhurni u largua.

— C'do të bëjmë, inxhinier? — pyeta.

— As që mund të mendoja të ndodhët kësh-tu... Po, mirë që ngjau tani... Duhet ta heqim shtyllën e betonit. Me siguri ndonjë burim uji ka gjetur rrugëdalje. Do të gërmojmë ende dhe ndonjë metër e gjysmë poshtë niveli të themelave, pastaj ta mbushim me betonarme. Të paktën betonimi i vendit të shembur duhet të bëhet sonte... ndry-she e keqja mund të shkojë më tej... Ikë me vrap e na merr nja dy baromina! Shtylla e betonit nuk mund të hiqet pa e shkatërruar, bile do të na duhet ta bëjmë këtë me dinamit — më tha inxhinieri.

Kur u ktheva përsëri në vendin e ngjarjes, punëtorët ja kishin nisur punës. Disa gërmimonin me kazma përreth shtyllës së betonit, të tjerët largo-nin dheun.

— «Këtej, shokë, këtej, më tepër forca» — foli inxhinieri duke miur me kazmë nga pjesa e sipërme e shtyllës. Shiu bënte punën e tij pa e prishur fare terezinë. Prozhektori lëshonte rreze të ndritshme mbi punëtorët e lagur. Inxhinier Ilia punonte i kërrusur me çizmet e zhytura në baltë, atje në mes të punëtorëve. Fundi i themelit po zbulohet dhe balta po bëhej më e mërzitshme.

— Shplodhu pak, inxhinier. Ma jep mua kaz-mën tënde — u dëgjua zëri i Qezarit, që sapo ishte kthyer nga posta. Inxhinieri ndali. Qezari kishte hedhur dorën në bisht të kazmës. Për një sekondë dy shikime përqafuan njëri-tjetrin. Inxhinieri e la kazmën dhe me cepin e xhaketës fshiu fytyrën, që i kullonte djersë e ujë shiu.

## AJO ŪSHTË VAJZA E TIJ

Nata ishte e errët, qelli i mbështjellë me shtëllunga resh të dendurë, që lëviznin drejt veriut si me përtim. Katundi Guraç kishte rënë në qetësi. Vetëm tej, nga shkolla e fshatit. dëgjohej deri në rrugë melodia e një këngë me çifteli. Kjo i tërhoqi vëmendjen Llesh Carës, dhe ai ndërroi rrugë. Kaloi një përrua të vogël, u fut në parcelën me misër dhe pas pak u gjend në oborrin e shkollës. Me hapa të ngadalshëm ju afrua dritares nga vini zërat dhe me kujdes afroi sytë në qoshe të xhamit, ku perdja kishte mbetur pak e hapur. Pas pak, ai rrudhi vetullat, lëvizi një herë nga vendi, ktheu kokën prapa si të ruhej se mos e zinin në faj dhe i nguli përsëri sytë në qoshen e dritares.

«More, ç'po bëhet këtu, xhanëm?.. Kë martojnë?!. Hëm... ky është ahengu që tregonte me qesëndi e shoqja e Nik Prelës dje ndër dhen?, mendoi ai i inatosur. Në çast, një vetëtimë çau errësirën dhe përsëri u shua, për t'ja lënë radhën një gjëmimi të fortë që erdhi nga ana e detit. Por Llesh Carës nuk ja tërhoqi vëmendjen ajo. Ai lëvizte kokën sa në një anë në tjetër për të parë më mirë se ç'bëhej atje brenda. Nga zërat dukej

se në klasë ishin djem dhe vajza, por se sa dhe cilët, këtë nuk po e gjente dot Lleshi, pasi nga ajo e shkretë perde qe hapur vetëm një vizë e hollë, prej ku ai mundi të shihte Marien, të bijën, Davën e Marka Zefit dhe mësuese Merin. Ato ishin ulur pranë njëra-tjetrës dhe po bisedonin duke qeshur. Ndërsa Lleshi dëgjonte me gjysmë fryme, në vesh i erdhën ca fjalë që s'po i kuptonte dot.

— Cohu, moj nuse, laju këmbët miqve! — Ha-ha-ha — u dëgjuan të qeshura.

— Sa i paska thonjtë, s'i paska pre qysh se ka le! — Ha-ha-ha — qeshën përsëri.

«Ç'domethanë kjo?.. për ke po e hedhin fjalën? Ç'asht kjo nuse këtu?..» — mendoi ai me vete dhe inati i hipit më keq kur pa të bijën që po queshte me gjithë shpirt.

Ca pika të mëdha e të rralla shiu, që filluan të bien me rrëmbim, e sollën në vete. Ngriti irripin e pushkës, që po i rrëshqiste nga supi dhe u largua pak nga dritarja. Mendoi të futej në klasë, por, ndërkokë, nga brenda dëgjoi zërin e sekretarit të partisë të fshatit:

— Si thoni tani, djema? Bëjmë pak pushim, dhe pastaj i përsërisim edhe një herë?

— Po, po, bëjmë pushim, — u përgjegjën disa.

Në dhomë u përzjenë zérat dhe dikush hapi derën e klasës për të dalë në korridor. Llesh Cara u largua me hapa të gjatë dhe mori një rrugicë për në shtëpi. Kur u fut në përruan e vogël matanë shkollës, pikat e shiut u shtuan më tepër. Aty i shkau këmba dhe për pak ra në një pellg me ujë. Po shpejt u ngrit dhe, pasi këputi një të sharë të rëndë, bëri përpara nëpër errësirë:

«Ej... or Llesh Cara, ç'po shkon në konakun tand! Ti ruen bagëtinë e fshatit në mal, kurse goca jote rri deri në mesnatë në aheng. Ishalla të gjesh plakën në shtëpi të paktën» — po grindej ai me vete.

Llesh Carës i ishte thyer zemra keqas me të bijën. Një vit më parë, Maria ishte ngritur para gjithë katundit dhe kishte lënë burrin, që ja kishte «vluar tata» qysh kur ishte pesë vjeçë. Ajo kishte qenë dita e kiametit për Llesh Carën. **Bile në mbrëmje nuk kishte fjetur në shtëpinë e tij. Kishte shkuar te krushqit e vjetër, si duket për t'u shfajësuar.**

Pas asaj të papriture, që nuk i ndodhi vetëm Lleshit, Maria bashkë me tri shoqe të tjera shkuar vullnetare në hekurudhën Elbasan-Përrrenjas. Edhe ajo ditë qe e rëndë për Lleshin. Ai nuk mund të mendonte dot se si ajo, Maria, që kishte vajtur në qytetin më të afërt vetëm një herë, do të shkonte aq larg, në një vend fare të panjohur. Po ato ikën, dhe ai mundohej të mos i kujtonte më, por ja që një tjetër hall po i dilte tani: organizata e rinisë e fshatit kishte formuar një grup artistik për t'u paraqitur në festivalin e estradave të kooperativave bujqësore. Kështu, çdo pasdite, pasi kthehezin nga fusha, pjesëtarët e grupit mblidheshin në shkollë e zhvillonin provat deri vonë. Ky ishte «ahengu» që e vuri në mendime Llesh Carën.

Aty nga ora tetë e mbrëmjes, pjesëtarët e grupit artistik dolën nga shkolla; zërat e tyre përhapeshin në errësirë. Përpara shtëpisë së saj Maria u nda nga shoqet, ngjiti shkallët duke fërkuar duart dhe u fut në dhomën e zjarrit.

— Mirë mbrëma... oh, si je, babë? — ju drejtua të atit, që gjatë asaj jave nuk kishte ardhur në shtëpi.

— Nga ishe deri në këtë vakt, moj «lule»?

— Në mbledhje, baba, në shkollë.

— Në mbledhje, babaaa... në mbledhjee... — e përqeshi ai. — Çfarë mbledhje? Pse s'thue në aheng? Don me më rrejtë mue? Shoh dhe këndeja unë, — i tha ai duke i rënë trurit të vogël me pëllëmbën e dorës.

— Jo, babë, nuk desha të të treg, nuk të kam tregjtë ndonjëherë. Në shkollë ishim mbledhur për provat e grupit teatral.

— Si, si?... Grupi thjatral?... Don me luejtë thjatra?... Hej, mor Llesh Cara, si lum ti... do të luejë goca thjatër. Po ne qenkemi për të shtrue darkë sonte, moj grue — i tha së shoqes duke e shikuar me inat dhe ju kthyesh përsëri së bijës me ironi: — Allahile, e kur kështu, moj Mari?

— Ka pesë ditë që u vendos në organizatën e rinisë dhe tashti kemi filluar provat — ju përgjegj ajo me seriozitet, pa e përfillur ironinë e tij.

Lleshi e dëgjoj kokëulur dhe, pas një heshtjeje të shkurtër, ngriti si me përtim sytë e shikoi të bijën nën vetulla.

— Po kush të ka bërë ty moj, ne apo rinia?

— e pyeti me zë të çjerrë dhe, pasi tendosi trupin vazhdoi:

— Moj, po a je në vete ti, apo ke dalë faret, xhanëm?

— Pse, baba?

— Si moj, pse babaaa... a ka zot kjo shtëpi, apo do të bëni ju si ju do qejfi? — briti me zë të

lartë dhe duke shikuar herë të bijën e herë të shoqen.

— Ç'ke kështu, mor burrë, pash zotin, dhe një natë që vjen me shamatë të shkretën?!

— U mërzite ti a?.. Mbylle gojën, se dhe ti ke fajet e tua! Më rri e mbyllur këtu si hutë, dhe kjo bredh deri në këtë vakt.

Llesh Carës i kishin hipur të tijat dhe po shfrynte i egërsuar, ndërsa Maria e dëgjonte e qetë; ajo e njihte mirë natyrën e të atit. Ai, zakonisht kur nevrikosej më tepër bërtiste e shante, bile ndonjëherë shkonte dhe më tej... Megjithëse kjo ndodhët nja dy vjet më parë, atëhere kur Maria ishte e vogël dhe i dëgjonte urdhërat e të atit, mendimet e tij si një ligj të shenjtë e të pakundër-shtueshëm. Kurse tanë që ajo e dëgjonte si prind, e shikonte me tjetër sy, i vlerësonte fjalët e tij me ligjet e reja të shoqërisë, nuk mund t'i dëgjonte në heshtje mendimet e tij të padrejta, prandaj, pas një pauze të shkurtër, ju përgjegj me guxim:

— Jo, baba, unë nuk bredh rrugëve... unë isha në shkollë bashkë me shoqe e shokë, bashkë-fshatarët tanë. Atje është dhe Dava e Marka Zefit me tri të tjera, dy mësueset e fshatit dhe...

— Nuk më duhet mua se kush asht aty, unë shikoj shtëpinë time. Më digjon, apo jo? Unë nuk due të qeshë fshati me mue. Aaa... mjaft e ke lirue litarin. Në thjatër nuk do të shkosh ma, ndryshe, o këtu, o aty!

Të nesërmen Maria nuk shkoi në prova. Shogët e shokët e grupit e mësuan arësyen dhe menduan që t'i vinin Llesh Carës një fletërrufe në qendër të fshatit. Lleshi nuk ishte njeri i keq as

nga qëndrimi i tij e as nga shpirti. Ai e kishte ngritur kokën vetëm pasi kishte ardhur në fuqinë pushteti i popullit. Këto mendoi mësuese Meri dhe Luigji, sekretari i rinisë së fshatit, të cilët ju lutën shokëve që fletërrufënë ta vinin pasi atatë shkonin e të takoheshin një herë me Llesh Carën...

Pasi mësoi arësyen e ardhjes së mësueses dhe sekretarit të rinisë, Lleshi u përgjegj prerë:

— Po, po, unë e kam ndalue Marin të mos vijë në ate thjetron. Familja e Carajve nuk i ka për fis asì punësh; zot i kësaj shtëpie jam ende unë, kur të vdes unë, atëhere le të bredhë ajo sitë ketë qejf.

— Mos na fyej, Llesh Cara — ja priti sekretari i rinisë i prekur në sedër. — Ajo nuk është atje vetëm, ka shoqe dhe shokë bashkëfshatarë të saj. Ne nuk bredhim, por mblidhemi pér të kryer një detyrë që e kërkon koha dhe që është në interes të gjithë kooperativës.

— Po si or çun, në çdo gja, në çdo zakon, do të dilni kundër prindërve tuej?... Ju, nuk ju ka pjellë guri!

— Jo në çdo gjë, por ato ligje a zakone që kanë rënduar mbi ju ne nuk do të lemë të peshojnë dhe mbi ne. Dhe kjo... nuk do të thotë se ne harojmë që na kanë lindur prindërit tanë, të mirë, por me disa mbeturina nga koha e kaluar.

Ndërsa këto fjalë e vunë në mendime Llesh Carën, sekretari i rinisë vazhdoi:

— Shokët dhe shoqet e rinisë vendosën të vinin fletërrufe te zyrat e kryesisë, po unë dhe mësuesja nuk i lamë, thamë të bisedonim një herë.

\* \* \*

Ja edhe dita erdhi. Në qytetin e vogël industrial, ku do të zhvillohej festivali, kishte një gjallëri të veçantë. Qindra njerëz, punëtorë e fshatarë, ishin mbledhur rreth kinemasë së qytetit. Salla e kinemasë ishte mbushur sa s'kishe ku hidhje mollën. Edhe në rrugicat midis rreshtave të karri-geve ishin ulur njerëzit. Unë kisha zënë një vend aty nga rreshtat e parë. Në skenë doli një vajzë e re e shoqëruar nga drita e kuqe e prozhektorëve; ajo priti një çast sa ra qetësia në sallë dhe, me një zë të pastër e të qartë, njoftoi publikun:

— Grupi diletant i kooperativës bujqësore të Guraçit paraqitet në festivalin e kooperativave bujqësore të rrethit me premierën «Të kalojmë pen-gesat».

Pranë meje ishte ulur një shoku im, vendas, në krahun e djathtë, kurse në krahun tjetër kisha një fshatar rreth të pesëdhjetave, me një palë vetulla të rëna mbi sy, që rrinte aq i ngrysur, si ta kishin sjellë aty me pahir. Skena u gjallërua, kur në të vërshoi i gjithë grupi.

Aktorët interpretuan me gjithë shpirt. Në sallë krisi gazi, kur një vajzë e veshur tebdil imitonte një grua llafazane. Edhe fshatari aty pranë, për çudinë time ishte gjallëruar e po queshte i habitur.

Aty nga fundi i shfaqjes në skenë doli një djalë i ri, me një trup të gjatë e flokë të zez, që i kishin dalë nga qeleshja e bardhë dhe një vajzë e re veshur me kostum kombëtar. Karriga ku ishte ulur fshatari filloi të kërciste më shumë. — C'gen-

ka ky, — mendova përsëri me vete, ndërsa spikerja foli qartë.

— Këngën e njojur «Kuvendon Marta me gra» do ta këndoje solistja jonë Marie Cara, shoqëron me çifteli Luigj Zoga.

Heshtje. Në sallë filloj të përhapej melodja e ëmbël e një zëri të pastër. «Oh... sa mirë» — murmurita me vete padashur, dhe u ktheva nga fshatari, që kishte drejtuar trupin dhe po shikonte i habitur. Heshjtja u bë më e thellë. Këngëtarja vazhdonte e sigurtë e plot ndjenja, thuajse po bisedonte me njerëzit që e dëgjonin plot respekt.

Pas mbarimit, në sallë shpërthyn duartrokitjet. Ajo përkuli kokën në shenjë mirënjohjeje dhe bëri të dilte nga skena, po aty nga mesi i sallës dikush thirri «bis». Kjo u përsërit nga shumë zëra dhe u shoqërua nga një breshëri duartrokitjesh. Instrumentistit i shkëlqyen sytë nga gëzimi dhe si i hutuar thirri Marien pér të përsëritur këngën.

Ajo filloj të këndonte përsëri po aq ëmbël.

Fshatari, që kisha në krahun tim, ishte ngritur në këmbë me sytë ngulur në skenë.

— Ç'qenka ky tip i çuditshëm? — i pëshpërita shokut në krah, duke i treguar fshatarin e ngritur në këmbë.

— Hë, hë — qeshi shoku dhe shtoi: — Ajo që këndoi është vajza e tij.

Kureshtja pér të njojur fshatarin e çuditshëm bëri të mësoja edhe tregimin që lexuat.



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Lapiðari në qafën e malit .....	3
Të shkuara, usta .....	16
Gjëmimet e para .....	30
Gabimi i një shoferi .....	42
Mysafirja .....	54
Njollat .....	73
Në gji të jetës .....	87
Ajo është vajza e tij .....	100